

Silvana Mojsovska

PLATFORMA **PAS BREGZIT**
PËR BASHKËPUNIM
TREGTAR NDËRMJET
MAQEDONISË SË VERIUT
DHE MBRETËRISË TË
BASHKUAR



PLATFORMA **PAS BREGZIT**
PËR BASHKËPUNIM
TREGTAR NDËRMJET
MAQEDONISË SË VERIUT
DHE MBRETËRISË TË
BASHKUAR

Dhjetor 2020



CIP – Каталогизација во публикација


Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

339.56(497.7:410)(047.31)

МОЈСОВСКА, Силвана

Постбрегзит платформа за трговска соработка помеѓу Република Северна
Македонија и Обединетото Кралство / Силвана Мојсовска. – Скопје : УНОПС,
2020. – 65 стр. : илустр. ; 21 см

Фусноти кон текстот. – Библиографија: стр. 64-65





Për AUTORËT

D-R SILVANA MOJSOVSKA është profesore e rregullt në Institutin ekonomik pranë Universitetit “Shën Kiril dhe Metodi” – Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut. Interesi i saj profesional është në fushën e ekonomisë ndërkombëtare, EU – integrimet, reformat strukturore dhe krijimin e politikave në fushën e ekonomisë. Ka një krijimtari të gjërë të hulumtuesve dhe projekteve aplikuese dhe është autor i një numri të punimeve shkencore, analizave, dhe studimeve nga këto fusha.

KJO ANALIZË është bërë me mbështetje të projektit “Mbështetje nordike për përparimin e Maqedonisë së Veriut”, të financuar nga mbretëritë e Norvegjisë dhe Suedisë, kurse është realizuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për shërbimeve projektuese (UNOPS). Përgjegjësia për përmbajtjen është e autorit dhe e njëjta nuk pasqyron qëndrimet e donatorëve, Sekretariatit për çështje europiane të Qeverisë të Maqedonisë së Veriut dhe UNOPS. Ndarja e analizës është e lejuar për qëllime jokomerciale me përmendjen e burimit.



PËRMBLEDHJE

Ky punim ka për qëllim që të identifikojë çështjet kryesore të platformës pas bregzit për bashkëpunim tregtar ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar dhe të jap vlerësim për mundësitë / sfidat që ajo sjell.

Bregzit ka ndodhur në 31 janar të vitit 2020. Mbretëria e Bashkuar edhe formalisht ndërpreu anëtarësimin në BE, por në fakt mbeti pjesë e tregut të vetëm ekonomik deri në 31 dhjetor të vitit 2020. Në këtë periudhë tranzicioni, transaksionet ekonomike dhe transaksionet tjera kryhen sipas rregullave të tregut të përbashkët, kurse Mbretëria e Bashkuar është e detyruar që të kryejë pagesat në buxhetin e Bashkimit European. Vijon rregullimi i marrëdhënieve tregtare dhe marrëdhënieve tjera ndërmjet dy palëve. Tregtia është veçanërisht e rëndësishme duke patur parasysh marrëdhëniet tregtare ndërmjet dy palëve. Në rast të marrëveshjes të lidhur deri në fund të vitit 2020, tregtia ndërmjet dy palëve do të realizohet sipas rregullave të reja të kontraktuara preferenciale, kurse në të kundërt, do të fillojnë të zbatohen rregullat e Organizatës botërore tregtare.

Ekzistonte mundësia për vazhdimin e periudhës së tranzicionit për 12 apo 24 muaj, e cila mund të dakordohet deri në 1 korrik të vitit 2020. Ajo nuk është shfrytëzuar, ashtu që Mbretëria e Bashkuar në 1 janar të vitit 2021 do të dalë nga tregu i përbashkët i BE. Në këtë mënyrë, Bregzit do të rrumbullaksohet. Dinamika e (ri)vendosjes të trajtimit preferencial në marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet dy palëve varet nga arritja e marrëveshjes për çështjet tregtare dhe çështjet tjera.

Në kontekst të daljes nga BE, Mbretëria e Bashkuar duhet të rregullojë edhe marrëdhëniet me vendet e treta të cilat kanë marrëveshje tregtare me Bashkimin European. Pas periudhës së tranzicionit, gjatë shkëmbimit tregtar të Mbretërisë të Bashkuar me këto vende do të ndërpritet vlefshmëria e dispozitave nga marrëveshjet e tyre preferenciale me BE. Në këtë grup bën pjesë edhe Republika e Maqedonisë së Veriut. Gjatë vitit 2019, të dy palët u janë qasur negociatave për lidhjen e Marrëveshjes për partneritet, tregti dhe bashkëpunim. Rregullimi bilateral i marrëdhënieve tregtare ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar është shumë i rëndësishëm për të dy vendet. Tregtia maqedonase-britanike në dekadën e fundit ka shënuar një rritje shumë të lartë, kryesisht e nxitur nga aktivitetet e IHD në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Mbretëria e Bashkuar ka marrë pjesë me 11,5% në importin e përgjithshëm maqedonas në vitin 2019. Njëkohësisht, rreth 90% nga ky import është në tre produkte – platinium, paladium dhe uranium (legura) të cilat i importon kompania britanike “Xhonsen Meti” për nevojat e prodhimit të saj (IHD) në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Nga ana tjetër, pjesa e eksportit të Republikës të Maqedonisë së Veriut në eksportin e përgjithshëm britanik në secilën prej kategorive të theksuara tarifore ka qënë 41,1% tek platiniumi, 39% tek paladiumi dhe 10,6% tek uraniumi (legurat) në vitin 2019. Kjo e vërteton ndërlidhjen e IHD britanike me eksportin britanik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, që zakonisht tërheq interes më të madh të shteti investues për sigurimin e kushteve më të mira për tregtinë e firmave të tyre.



Në anën e eksportit, Mbretëria e Bashkuar ka marrë pjesë me 2,2% në eksportin e tërësishëm maqedonas në vitin 2019. Kjo pjesë është mjaftë e vogël sepse pjesë më e madhe nga eksporti i IHD shkon në Gjermani. Vendosja organizative e këtyre IHD është e tillë që importojnë lëndë të para nga vendi domicil, kryejnë prodhimin në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe prodhimet e gatshme i eksportojnë në Gjermani. Analiza e prodhimeve më të eksportuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Gjermani e vërteton një gjë të tillë. Për ilustrim, dy produktet kryesore të eksportit të Republikës të Maqedonisë së Veriut, të cilat kryesisht plasohen në Gjermani (katalizatorët me bazë të metalit të çmuar, dhe makinat dhe pajisjet për pastrim dhe gazërat filtruese), i eksporton kompania "Xhonsen Meti".

Kjo vijueshmëri e tregtisë, gjatë të cilës importimi i lëndëve të para është nga një shtet (Mbretëria e Bashkuar), prodhimi i produkteve të gatshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kurse eksporti në shtet tjetër (Gjermani) udhëzon në çështjen për nevojën e përdorimit të instrumentit origjina e mallrave. Gjatë strukturës aktuale të shkëmbimit, ky instrument nuk përdoret në mënyrë domethënëse gjatë tregtisë britanike – maqedonase – gjermane, por mund të bëhet i rëndësishëm për rrjedhën tregtare pas bregzit. Rrjedhimisht, kjo çështje duhet të rregullohet në mënyrë sistemore.


Marrëveshja për partneritet, tregti dhe bashkëpunim ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar ka për qëllim që të vendos platformën për bashkëpunim tregtar pas bregzit ndërmjet dy vendeve. Marrëveshja në masë të madhe është e bazuar në Marrëveshjen për stabilizim dhe asocim të Republikës të Maqedonisë së Veriut me BE. Me marrëveshjen vendoset zona për tregti të lirë ndërmjet Republikës të Maqedonisë të Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar dhe parashihet që të mos ketë periudhë të mosrregullimit të marrëveshjeve të ndërsjella tregtare. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme sepse në të kundërtën do të vlejnë dispozitat e Organizatës botërore tregtare. Marrëveshja duhet të fillojë të zbatohet pas daljes të Mbretërisë të bashkuara nga tregu i përbashkët i BE-së. Në lidhje me dispozitat specifike të MSA me të cilat parashihet mbrojtja e produkteve të caktuara, zgjidhjet nga Marrëveshja për partneritet, tregti dhe bashkëpunim janë mjaftë të favorshme për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kuotat e definuara për produktet e përcaktuara japin hapësirë për intensifikim domethënës të tregtisë ndërmjet dy palëve, kurse tregtia me tekstil, veshje dhe produkte të çelikut është liberalizuar nga vetë fillimi. Në lidhje me kumulimin e prejardhjes të mallrave, është paraparë zgjidhje bilaterale shtrirja territoriale e të cilës siguron mbajtjen e kushteve ekzistuese të tregtisë

Vlerësimi është se në Marrëveshjen për partneritet, tregti dhe bashkëpunim MSA janë pasqyruar përfitimet nga MSA dhe janë dhënë mundësitë për avancimin e marrëdhënieve tregtare ndërmjet palëve, duke ndjekur parimet e konkurrencës dhe tregut të lirë. Shfrytëzimi i mundësive nga kjo marrëveshje është kushtëzuar nga proaktiviteti i institucioneve relevante dhe bashkësisë afariste dhe, në atë kuptim, nevojitet promovim përkatës i platformës pas bregzit për bashkëpunimin tregtar maqedonas – britanik.



PËRMBAJTJA

Hyrje	15
1. Shqyrtimi i tregtisë të jashtme në Republikën e Maqedonisë së Veriut	21
1.1. Vëllimi i tregtisë të jashtme të Republikës të Maqedonisë së Veriut	22
1.2. Partnerët tregtar të Republikës të Maqedonisë së Veriut nga BE	26
1.3. Struktura e tregtisë të jashtme maqedonase	28
2. Analiza e tregtisë të jashtme ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar	35
2.1. Struktura e importit maqedonas nga Mbretëria e Bashkuar sipas produkteve	35
2.2. Struktura e eksportit maqedonas në Mbretërinë e Bashkuar sipas produkteve	42
2.3. Kompanitë me pjesëmarrje më të madhe në importin/eksportin e Republikës të Maqedonisë së Veriut nga/në Mbretërinë e Bashkuar	46
3. Platforma pas bregzit për marrëdhëniet tregtare ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar	53
Përfundimi	59





Lista e SHKURTESAVE


MPBT	Marrëveshja për partneritet, bashkëpunim dhe tregti
BE	Bashkimi European
PEM	Konventa e rregullave paneuromesdhetare preferenciale të prejardhjes
IHD	Investimet e Huaja Direkte
KNST	Klasifikimi Ndërkombëtar Standard i Tregtisë
MSA	Marrëveshja për stabilizim dhe asocim
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
HS	Sistemi i harmonizuar

Lista e GRAFIKËVE

1. Tregtia e jashtme e MV me BE në periudhën 2000-2019	22
2. Partnerët më të rëndësishëm tregtarë nga BE në Republikën e Maqedonisë së Veriut - import	26
3. Partnerët më të rëndësishëm tregtarë nga BE në Republikën e Maqedonisë së Veriut - eksport	27
4. Segmentet e KNST me import më të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut	29
5. Segmentet e KNST me eksport më të lartë nga Republika e Maqedonisë së Veriut	30

Lista e TABELAVE

1. Tregtia e Republikës të Maqedonisë së Veriut me Mbretërinë e Bashkuar	35
2. Importi në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga Mbretëria e Bashkuar sipas produkteve	37
3. Eksporti nga Mbretëria e Bashkuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas produkteve	40
4. Eksporti nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Mbretërinë e Bashkuar sipas produkteve	43
5. Importi në Mbretërinë e Bashkuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut sipas produkteve	44
6. Kompanitë me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut me import/eksport më të lartë nga/në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2018	46
7. Kompanitë me import më të lartë nga Mbretëria e Bashkuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2018	47
8. Kompanitë me eksport më të lartë nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2018	48
9. Dhjetë produktet më të importuara nga Republika e Maqedonisë në Gjermani në vitin 2018	51





Hyrje

Në pajtim me referendimin e Mbretërisë të Bashkuar të mbatur në datë 23 qershor 2016, në të cilin shumica e votuesve janë deklaruar për daljen e vendit nga Bashkimi European, filloi procesi për realizimin e të ashtq. Bregzit. Vendimi i referendimit është vërtetuar nga parlamenti britanik, kurse si datë për dalje është përcaktuar 29 marsi i vitit 2019. Në ndërkohë kanë vijuar negociatat ndërmjet Mbretërisë të Bashkuar dhe BE-së për lidhjen e marrëveshjes për dalje, respektivisht definimin e kushteve dhe rregullave që do të vlenin në marrëdhëniet ndërmjet dy palëve qëkur Mbretëria e Bashkuar do të dalë nga BE. Në maj të vitit 2019, parlamenti britanik nuk e ka pranuar propozim – marrëveshjen e arritur ndërmjet ekipit të kryeministres britanike Tereza Mej dhe ekipit të BE-së. Në vazhdim, erdhi deri te ndryshimi i udhëheqjes politike në Mbretërinë e Bashkuar. Boris Xhonson u bë kryeministër në korrik të vitit 2019 me premtimin për daljen nga Bashkimi European pa marrëveshje deri në 31 tetor të vitit 2019. Megjithatë, nuk erdhi deri te realizimi i Bregzit pa marrëveshje, por deri te negociatat e sërishme ndërmjet dy palëve dhe shtyrjen e Bregzitet deri në 31 janar të vitit 2020. Në 12 dhjetor të vitit 2019 janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Mbretërinë e Bashkuar, rezultati i të cilave ishte fitore bindëse e Partisë demokratike në krye me Boris Xhonson, me çrast u bë e sigurtë që Bregzit përfundimisht do të realizohej.¹

Në 20 dhjetor të vitit 2019, parlamenti britanik fillimisht ka mbështetur propozim – ligjin për marrëveshjen për tërheqjen e Mbretërisë të Bashkuar nga BE,² kurse procedura për miratimin e tij ka përfunduar në janar të vitit 2020. Me këtë ligj është rregulluar mënyra në të cilën Mbretëria e Bashkuar do të realizojë pagesat ndaj BE-së që rrjedhin nga dalja britanike nga Bashkimi European; janë përcaktuar kompetencat e institucioneve britanike për rregullimin e marrëdhënieve në fushat e ndryshme dhe është përcaktuar periudha tranzitore prej 11 muajsh (deri në 31 dhjetor 2020) për rregullimin e kontraktuar të çështjeve tregtare dhe çështjeve tjera ndërmjet dy palëve. Ligji për marrëveshjen për tërheqjen e Mbretërisë të Bashkuar nga Bashkimi European në masë të madhe i përmban elementet e dakorduara nga ana e ekipit të Tereza Mej, kurse dallimi thelbësorë është në atë se ekipi i Boris Xhonson bëri marrëveshjen për vendosjen e kufirit fizik ndërmjet palës britanike dhe Irlandës të Veriut për qarkullim të mallrave në vend të ashtq. zgjidhje “më të butë” për kufi të hapur, për të cilën angazhohej Mej. Kufiri tregtar ndërmjet dy palëve është zgjidhje që nënkupton se Irlanda e Veriut do të dalë nga BE (si pjesë e Mbretërisë të Bashkuar), megjithatë do të vazhdojë të zbatojë rregullat dhe standardet e BE-së, sidomos në lidhje me politikën bujqësore, që do të pasqyrohet në tregtinë ndërmjet palës britanike dhe Irlandës veriore. Detajet reth tregtisë ndërmjet dy palëve, sidomos në lidhje me tregtinë me ushqim, do të jenë lëndë e negociatave shtesë ndërmjet BE-së dhe Mbretërisë të Bashkuar.

Dalja e Mbretërisë të Bashkuar nga BE ka ndodhur në 31 janar të vitit 2020. Atëherë vendi formalisht e ka ndërprerë anëtarësinë në Bashkimin European. Megjithatë, dalja nga tregu i përbashkët është parashikuar që të jetë me periudhë tranzitore prej 11 muajsh. Gjatë periudhës tranzitore duhet të rregullohen marrëdhëniet tregtare dhe marrëdhëniet tjera ndërmjet të dy palëve. Në fakt, deri

¹ <https://www.gov.uk/brexit>, është qasur në datë 20.05.2020.

² <https://www.parliament.uk/business/publications/research/eu-referendum/legislation/>, është qasur në datë 20.05.2020.



në 31 dhjetor të vitit 2020, Mbretëria e Bashkuar do të mbesë pjesë e tregut të vetëm europian dhe do të respektojë rregullat e BE-së, kurse do të kryejë edhe pagesat në buxhetin e BE. Bashkimi Europian është një partner shumë i rëndësishëm tregtar për Mbretërinë e Bashkuar, duke patur parasysh se 49% nga tregtia e tërësishme britanike në vitin 2018 është kryer me BE, kurse 11% me shtetet të cilat kanë marrëveshje tregtare me BE.³ Rjedhimisht, Bregziti tërheq urgjencën për rregullimin e marrëdhënieve britanike me BE dhe me shtetet të cilat kanë marrëveshje tregtare me BE.

Negociatat tregtare ndërmjet dy palëve do të bazohen mbi deklaratën politike që BE dhe Mbretëria e Bashkuar e kanë nënshkruar në tetor të vitit 2019.⁴ Në deklaratë është theksuar se marrëveshjet e mëtutjeshme ndërmjet dy palëve do të bazohen mbi partneritetin ekonomik ambicioz, të gjërë dhe të balancuar. Bërthama e marrëveshjeve ekonomike do i kushtojë marrëveshjes për tregti të lirë, kurse është paraparë që të ketë një bashkëpunim më të gjërë sektorial, i cili është i rëndësishëm për të dy palët. Kjo e vërteton përcaktimin e përbashkët për rregullimin e marrëdhënieve tregtare në frymën e arritjeve të tregut të përbashkët. Megjithatë, rregullimi përfundimtar i marrëdhënieve tregtare për mallërat dhe çështjet e caktuara të ndjeshme dhe do të jetë lëndë e negociatave. Për më tepër, tregtia mund të ngarkohet me shpenzime të reja sepse do të vendosen kufij fizik për kontrollimin e mallrave.

Ka shumë skepticizëm nga ana e BE se çështjet tregtare dhe çështjet tjera⁵ me Mbretërinë e Bashkuar do të rregullohen gjatë kohës të periudhës tranzitore prej 11 muajsh. Dy palët duhet të rregullojnë të gjithë çështjet me një akt të vetëm ligjor. Sigurisht që gjatë negociatave, prioritare do të jetë marrëveshja tregtare për të siguruar kontinuitet në punën e komunitetit afarist. Negociatat kanë filluar në mars 2020, dhe nëse vërtetohet se dinamika e marrëveshjes është e ngadalshme, ekziston mundësia që deri në 1 korrik 2020, të dy palët të dakordohen për vazhdimin e periudhës tranzitore për 12 apo për 14 muaj. Nëse nuk dakordohet vazhdimi deri në 1 korrik 2020, vazhdon të vlejë periudha tranzitore prej 11 muajsh, respektivisht Mbretëria e Bashkuar do të dalë nga tregu i përbashkët i BE-së në 1 janar të vitit 2021.

Në varësi nga ngjarjet gjatë vitit 2020, në lidhje me marrëdhëniet tregtare ndërmjet BE dhe Mbretërisë të Bashkuar janë të mundura këto skenare në 1 janar të vitit 2021:

1) Ekziston pajtueshmëri për çështjet tregtare (marrëveshje për tregtinë e lirë apo protokollin tregtar) ndërmjet BE dhe Mbretërisë të Bashkuar. Nëse mbyllet çështjet tregtare deri në fund të vitit 2020, kjo/ky marrëveshje/protokoll do të fillojë të zbatohet nga 1 janari i vitit 2021. **Ky skenar do të sigurojë një tranzicion relativisht të lehtë nga rregullat e tregut të përbashkët të BE drejtë kryerjes të shkëmbimit tregtar sipas dispozitave të marrëveshjes/protokollit për tregti të lirë.** Madje edhe në situatë nëse nuk arrihet një marrëveshje e plotë që do të rregullojë edhe çështjet jo tregtare për të cilat dy shtetet duhet të negociojnë, marrëveshja/protokollin për tregti të lirë do hyjë në fuqi pas kalimit të periudhës tranzitore. Praktika e shpeshtë është që protokollet tregtare të hyjnë në fuqi më shpejtë se marrëveshjet më të gjëra pjesa përbërëse e të cilave është edhe rregullimi i çështjeve tregtare, me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë të klimës afariste për operatorët ekonomik.

³ Ibid.

⁴ https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/revised_political_declaration.pdf, është qasur në datë 20.05.2020.

⁵ Çështjet tjera që duhet të rregullohen ndërmjet BE-së dhe Mbretërisë të Bashkuar i referohen kornizës ligjore, ndarjes të të dhënave dhe sigurisë, standardet në sigurinë e fluturimit ajror, qasja në ujërat e peshkimit, furnizimi me energji elektrike dhe gaz, licensat dhe rregullativat e ilaçeve.



2) Marrëveshja/protokolli për tregti të lirë nuk është lidhur dhe nuk ka vazhdim gjatë periudhës tranzitore. Nëse marrëveshja për tregti të lirë nuk është mbyllur, respektivisht nëse negociatat ndërmjet dy palëve nuk janë përfunduar, pas kalimit të periudhës tranzitore, nga 1 janari 2021, **marrëveshjet tregtare ndërmjet dy palëve do të duhet të realizohen sipas rregullave të Organizatës botërore të tregtisë (OBT), anëtarë të së cilës janë BE dhe Mbretëria e Bashkuar.** Këto rregulla bazohen mbi parimin e kombit më të privilegjuar, respektivisht tregtia britanike me BE do të duhet të jetë sipas rregullave të përgjithshme tregtare botërore, dhe jo sipas rregullave preferenciale për të dy palët.

3) Marrëveshja për tregti të lirë nuk është lidhur dhe ka vazhdimësi të periudhës tranzitore. Nëse gjatë negociatave tregtare vërtetohet se dinamika e tyre nuk do të rezultojë me mbylljen e marrëveshjes tregtare deri në fund të vitit 2020, ekziston mundësia për vazhdimin e periudhës tranzitore për 12 apo 24 muaj. Siç është theksuar më lartë, vazhdimi mund të dakordohet deri në 1 korrik 2020. Nëse vjen deri te vazhdimi i periudhës tranzitore, atëherë mund të pritët se në periudhën e re të definuar do të lidhet marrëveshja/protokolli për tregti të lirë ndërmjet dy palëve. Kjo do të thotë realizim të skenarit 1, vetëm me një kornizë të vazhduar kohore. Nëse edhe në periudhën e re të definuar tranzitore nuk lidhet marrëveshje/protokoll për tregti të lirë, atëherë do të paraqitet skenari 2.

Pandemia e Kovid -19, e cila që nga marsi i vitit 2020 e ka paralizuar jetën në pothuajse të gjithë vendet e botës, ka ndikuar edhe në negociatat tregtare ndërmjet Mbretërisë të Bashkuar dhe BE. Ata kanë filluar në mars në Bruksel, siç ishte planifikuar, kurse kanë vazhduar në prill dhe në maj, përmes përdorimit të mjeteve elektronike për komunikim.⁶ Fillimi e ka vërtetuar dyshimin se bisedimet do të vijnë me vështirësi. Dinamika e negociatave është e kufizuar për shkak të ngjarjeve në lidhje me Kovid – 19, ashtuqë lidhja e marrëveshjeve tregtare deri në fund të vitit 2020 bëhet gjithnjë e më pak reale. Edhe krahas kësaj, Mbretëria e Bashkuar mbetet në qëndrimin se nuk do të kërkojnë vazhdimin e periudhës tranzitore, as nuk do të pranojnë një ofertë të tillë nga ana e BE.⁷ Arsyeimi është se negociatat vetëm do të stërzgjatëshin, kurse qëndrimi i Mbretërisë së Bashkuar në tregun e përbashkët të BE tërheq shpenzime në kontekst të pagesave që vendi duhet t'i kryejë drejtë Bashkimit Europian. Në prag të samitit të BE në qershor të vitit 2020, pritët që të ketë diskutime më intensive edhe të dy palët në lidhje me çështjen e periudhës tranzitore. Nëse Mbretëria e Bashkuar mbetet në qëndrimin që të dalë nga tregu i përbashkët i BE-së në 1 janar të vitit 2021, atëherë do të shfaqet skenari 2. Tregtia ndërmjet të dy palëve do të zhvillohet sipas parimeve të OBT.

Paralelisht me rregullimin e marrëdhënieve tregtare me BE, Mbretëria e Bashkuar do të duhet të rregullojë edhe marrëdhëniet me vendet e treta të cilat kanë marrëveshje tregtare me BE. Pas dajljes të Mbretërisë të Bashkuar nga tregu i përbashkët i BE (pas përfundimit të periudhës tranzitore) gjatë shkëmbimit tregtar të Mbretërisë të Bashkuar me këto vende, do të pushojnë të vlejnjë dispozitat nga marrëveshjet e tyre preferenciale me BE. Rrjedhimisht, nëse Mbretëria e Bashkuar nuk lidh marrëveshje bileterale me ato, pas përfundimit të periudhës tranzitore (1 janar 2021 nëse nuk ka vazhdim), shkëmbimi tregtar do të zhvillohet sipas rregullave të OBT. Në këtë grup të vendeve bën pjesë edhe Republika e Maqedonisë së Veriut

⁶ https://ec.europa.eu/info/european-union-and-united-kingdom-forging-new-partnership/future-partnership/negotiation-rounds-future-partnership-between-european-union-and-united-kingdom_en, është qasur në datë 20.05.2020.

⁷ <https://www.bbc.com/news/uk-politics-52313042>, është qasur në datë 20.05.2020.

⁸ <https://www.sobranie.mk/documents-rm-eu.nspix>



Marrëdhëniet tregtare ndërmjet Mbretërisë të Bashkuar dhe Republikës të Maqedonisë së Veriut janë të rregulluara me Marrëveshjen për stabilizim dhe asocim (MSA) ndërmjet BE dhe Republikës të Maqedonisë së Veriut. Kjo do të thotë se pjesa më e madhe e tregtisë realizohet pa dogana, kurse mbrojtja në formë të kuotave zbatohet në produkte të caktuara.⁹ Në kontekst të daljes të saj nga Bashkimi European, Mbretëria e Bashkuara këmbëngul që të sigurojë rregullimin e marrëdhënieve me vendet e treta (jashtë nga BE), me qëllim që të mos ketë ndalesë në bashkëpunimin ekonomik dhe bashkëpunimin tjetër me ato. Rrjedhimisht, gjatë vitit 2019 të dy palët janë qasur në negociata për lidhje të Marrëveshjes për partneritet, tregti dhe bashkëpunim ndërmjet Mbretërisë të Bashkuar dhe Republikës të Maqedonisë së Veriut. Marrëveshja (në tekstin e mëposhtëm MPBT) në masë të madhe është bazuar në MSA. Në këtë studim analizohet versioni përfundimtar i MPBT, e cila është harmonizuar nga të dy palët.⁹

Ky punim ka për qëllim që të identifikojë çështjet kryesore për diskutim që janë të vlefshme për anën maqedonase dhe të jap mendim në lidhje me platformën pas bregzit për marrëveshje tregtare ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar.

Dokumenti përbëhet nga tre pjesë: 1) Shqyrtimi i tregtisë të jashtme të Republikës të Maqedonisë së Veriut me BE; 2) Analiza e tregtisë ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar dhe 3) Analiza e çështjeve tregtare dhe çështjeve tjera në lidhje me Marrëveshjen për stabilizim dhe asocim të lidhur ndërmjet BE-së dhe Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Marrëveshja për partneritet, tregti dhe bashkëpunim të Mbretërisë të Bashkuar dhe Republikës të Maqedonisë së Veriut.

Gjatë analizës të tregtisë, për anën maqedonase janë përdorur të dhënat nga baza – MAKSTAT të Entit shtetëtor për statistika të Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe të dhënat nga Drejtoria doganore, kurse për anën britanike është qasur deri në bazën INTRACEN të të dhënave të Qendrës ndërkombëtare për tregti pranë UNKTAD. Në lidhje me elementet tjera, janë konsultuar materialet në dispozicion që janë relevante për studimin. Në të njëjtën kohë, është bërë një analizë e thellë e dy dokumenteve – MSA dhe MPBT. Në fund të analizës është zhvendosur diskutimi në lidhje me mundësitë për avancim të mëtutjeshëm të marrëveshjeve tregtare ndërmjet dy palëve.

⁹ Në pajtim me informacionet nga Ministria maqedonase për punë të jashtme, nënshkrimi i MPBT është planifikuar për pranverën e vitit 2020, megjithatë situata e re e lidhur me Kovid-19 ka imponuar fokusimin vetëm në punët urgjente. Nënshkrimi është zhvendosur, por teksti është harmonizuar dhe përdorur për qëllime hulumtuese në këtë studim.





1.

Shqyrtimi i tregtisë të jashtme në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Analiza e tregtisë të jashtme në Republikën e Maqedonisë së Veriut është dhënë për një periudhë prej dy dekadash (2000 – 2019), me qëllim që në mënyrë më të duhur të identifikohet rëndësia e Mbretërisë të Bashkuar për anën maqedonase. Në këtë pikë është vendosur një pasqyrë e shkurtër në tregtinë e përgjithshme të jashtme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kurse fokusi më tutje është në elaborimin e tregtisë MK – BE në lidhje me vëllimin e tregtisë të ndërsjellë, partnerët tregtarë të Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe struktura e importit maqedonas dhe importi në sektorët / segmentet e KNST dhe prodhimet.

Gjatë analizës janë përdorur të dhënat nga baza MAKSTAT e Entit shtetëror për statistika të Republikës të Maqedonisë së Veriut.



1.1. Vëllimi i tregtisë të jashtme të Republikës të Maqedonisë së Veriut

Tregtia e përgjithshme e huaj e Republikës të Maqedonisë së Veriut karakterizohet me një **dinamikë shumë të fuqishme të rritjes në periudhën 2000 – 2019**. Është rritur për pothuajse 4.8 herë, respektivisht është vërejtur një rritje prej 3.1 në 14.9 miliard euro.¹⁰ Në të njëjtën kohë, rritje ka në të dy anët – të importit dhe eksportit. Importi ka qënë me shkallë më të lartë të rritjes pothuajse gjatë të gjithë periudhës, veçanërisht në periudhën 2006 – 2012. Në vazhdimësi, deficitit tregtar në periudhën e përmendur është thelluar nga 1.1 në pothuajse 2 miliard euro. Në periudhën 2012 – 2015 më shumë dinamikë është vërejtur në anën e importit, që ka rezultuar në zvogëlimin e deficitit tregtar të 1.7 miliard eurove në vitin 2015. Në këtë kontekst, **është me rëndësi të theksohet se ka ndodhur ndryshim në strukturën e importit, respektivisht është rritur eksporti i produkteve me një vlerë më të lartë të shtuar**. Sidoqoftë, në vitet e fundit sërish ka thellim të madh tregtar, i cili në vitin 2019 ka qënë mbi 2 miliard euro.

Në lidhje me partnerët tregtar, analiza e shkëmbimit tregtar të Republikës të Maqedonisë së Veriut tregon se BE është partneri kryesor tregtar i vendit në dy dekadat e fundit. **Pjesëmarrja e BE¹¹ në tregtin e përgjithshme të huaj maqedonase ka qënë 40% në vitin 2000, 58% në vitin 2008, 66,6 % në vitin 2013 dhe 70,5% në vitin 2019.**¹² Partnerë tjerë të rëndësishëm tregtar janë Serbia, Kina dhe Turqia. Në vijim do të analizohet tregtia e Republikës të Maqedonisë së Veriut me BE për shkak të rëndësisë të saj si partner më i madh tregtar, edhe për shkak të fokusit të studimit të sqaruar në hyrje.

Në grafikun 1 është dhënë pasqyrë e vëllimit të importit maqedonas dhe importit në/nga BE. Në periudhën 2000 – 2019¹³ vërehet rritje edhe në eksport edhe në import, ashtuqë në vitet e fundit eksporti shënon shkallë më të lartë të rritjes, që pasqyrohet në zvogëlimin e deficitit tregtar të Republikës të Maqedonisë së Veriut. Në vitin 2018 madje është shënuar suficit, kurse në vitin 2019, deficit prej 76 milion.

Trendet e treguara të tregtisë të Republikës të Maqedonisë së Veriut me BE mund të sqarohen përmes ndikimit të tre faktorëve:

- Nënshkrimi i Marrëveshjes për stabilizim dhe asocim (MSA) ndërmjet dy palëve në vitin 2001;
- Zgjerimi i Bashkimit European dhe
- Hyrja në të ashtuq IHD të “gjelbërta”¹⁴ në zonat e zhvilluara teknologjike – industriale në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga viti 2019 e kënde.

MSA, respektivisht marrëveshja e përkohshme tregtare që paraqet pjesë përbërëse nga MSA, ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2001 dhe ka vërtetuar qasjen e lirë për produktet maqedonase në tregun e BE, që për të shumtën e tyre tashmë është dhënë në Marrëveshjen për bashkëpunim nga viti 1998.¹⁵ Në të njëjtën kohë, në MSA është dakorduar një qasje asimetrike, respektivisht gjatë hyrjes në produktet e BE në tregun maqedonas është paraparë zvogëlim i shkallëzuar i doganave në periudhën prej 10 viteve. Kjo periudhë i referohet edhe produkteve tekstile, të cilat janë rregulluar në mënyrë të veçantë në

¹⁰ Baza e të dhënave MAKSTAT në Entin për statistika të Republikës të Maqedonisë së Veriut (<http://makstat.stat.gov.mk>)

¹¹ Të dhënat deri në vitin 2003 i referohen BE15, periudhës 2004–2006 të EU25, përderisa periudha 2007–2012 i referohet BE 27, kurse nga vitit 2013 e këtej në BE 28.

¹² Llogaritë janë bërë në bazë të të dhënave nga baza e të dhënave MAKSTAT të Entit shtetërorë për statistika të Republikës të Maqedonisë së Veriut (<http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef>)

¹³ Të dhënat për vitin 2019 janë të dhëna paraprake. Në momentin e kompletimit të analizës nuk ishin të disponueshme të dhënat përfundimtare nga Enti shtetërorë për statistika. Në raportet përfundimtare statistikore mund të paraqiten dallime ndërmjet të dhënave paraprake dhe përfundimtare.

¹⁴ Investimet “e gjelbërta” janë investime që nga fillimi në kapacitete të reja.

¹⁵ <https://www.sobranie.mk/documents-rm-eu.nsp>




Protokollin I nga MSA, përderisa në lidhje me industrinë e çelikut është paraparë periudhë prej 5 vitesh, e përcaktuar në Protokollin II nga MSA. Edhe pse MSA në përgjithësi siguroi liberalizim të tregut të BE, që menjëherë ka hyrë në fuqi për produktet maqedonase, megjithatë, për disa produkte janë paraparë masa shtesë të mbrojtjes.¹⁶ Këtu bëjnë pjesë produktet e ndjeshme, si vera, mishi i viçit të ri, peshku dhe produktet e peshkurt, për të cilat janë paraparë kuota pa doganë. Gjithashtu, kuotat janë definuar edhe për disa produkte tjera.

Dy faktorët, MSA dhe zgjerimi, mund të shqyrtohen bashkarisht. Rritja më e madhe e pjesëmarrjes të BE-së në tregtinë e jashtme maqedonase është realizuar në periudhën 2000 – 2004 (nga 40% në 52%). Zgjerimi nga viti 2004 nuk kishte ndikim të rëndësishëm sepse përveç se me Slloveninë, Republika e Maqedonisë së Veriut nuk kishte zhvilluar marrëdhënie tregtare me vendet tjera nga ajo valë e hyrjes në Bashkimin European. Rrjedhimisht, mund të diskutohet se mbi rritjen e tregtisë maqedonase me BE deri në vitin 2014 ka ndikuar liberalizimi me tregun e BE për produktet maqedonase, bashkë me ndikimin e vetëdijes të një pjesë të kompanive maqedonase për mundësitë e krijuara.

Më tutje, mund të përfundohet se zgjerimi i Bashkimit European nga viti 2007 me Bullgarinë dhe Romaninë ka patur ndikim të caktuar mbi rritjen e tregtisë, duke e patur parasysh se Bullgaria edhe para se të bëhet anëtare e Bashkimit European ishte një partner i rëndësishëm tregtar i Republikës të Maqedonisë

GRAFIKU 1.

Tregtia e jashtme e RM me BE në periudhën 2000 – 2019 (në '000 euro)



¹⁶ Ibid.



së Veriut. Zgjerimi me Kroacinë në vitin 2013, gjithashtu kishte një efekt të caktuar mbi rritjen e tregtisë të jashtme maqedonase me BE. Në kontekst të MSA, është me rëndësi fakti se në vitin 2011 ka përfunduar regjimi asimetrik i tregtisë dhe produktet e BE filluan të importohen në tregun maqedonas pa dogana. Kjo ka kontribuar për intensifikim të mëtejshëm të shkëmbimit, duke udhëzuar në atë që palët e përdorin liberalizimin gjatë tregtisë të tyre të ndërsjellë.


Megjithatë, **rritja e lartë e tregtisë maqedonase nga viti 2010 e këndej kryesisht është për shkak të faktorit të tretë – IHD “të gjelbërta” në industrinë e caktuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut. MSA, respektivisht zona e vendosur e tregtisë të lirë me BE, ka kontribuar për realizimin e këtyre investimeve, kurse ata kanë rezultuar në rritjen e vëllimit të tregtisë.** Ka ardhur deri te ndryshimi i strukturës të tregtisë maqedonase, me përfshirjen e produkteve me vlerë më të lartë në të dy anët – eksport dhe import.

Investimet e “gjelbërta” janë realizuar nga viti 2009 e këndej, në zonat e zhvilluara teknologjike – industriale. Sipas të dhënave nga Banka popullore e Republikës të Maqedonisë së Veriut,¹⁷ **IHD në vlerë prej 1.7 miliard euro kanë hyrë në periudhën 2009 – 2016**, që është vlerë më e ulët në krahasim me IHD prej 2.3 miliard euro në periudhën 2000 – 2008. Megjithatë, është e rëndësishme struktura e IHD. **Më konkretisht, rreth 790 milion euro (nga 1.7 miliard euro) janë investuar në prodhimtari, sidomos në sektorin “Automjete motorike, rimorkio dhe gjysëm rimorkio” ku janë hedhur rreth 574 milion euro.** Kjo paraqet një pikë të kthesës për tregtinë e jashtme maqedonase sepse IHD në këtë sektor filluan me prodhimin e produkteve me vlerë më të lartë të shtuar, kryesisht të destinuara për eksport. Në të njëjtën kohë, pjesë e madhe e këtyre kompanive i importojnë lëndët e para të nevojshme dhe inputet tjera për prodhim, që ka tërhequr ndryshimin edhe të anës të importit.

1.1 miliard euro shtesë IHD kanë hyrë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2007 – 2019. Në të njëjtën, rreth 473 milion euro janë investuar në prodhimtari, prej të cilave 373 milion euro janë investuar në sektorin “Automjete motorike, rimorkio dhe gjysëm rimorkio”. **Në periudhën 2003 – 2019, IHD të përgjithshme nga Mbretëria e Bashkuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë 380 milion euro. Prej tyre, 161 milion euro janë investuar në tre vitet e fundit (2017–2019).**¹⁸ Këto të dhëna janë pasqyruar në tregtinë e Republikën e Maqedonisë së Veriut me Mbretërinë e Bashkuar dhe me BE.

¹⁷ <http://nbstat.nbrm.mk/pxweb/mk/Eksterni%20statistiki/>, është qasur në datë 15.05.2020.

¹⁸ Ibid.





1.2. Partnerët tregtar të Republikës të Maqedonisë së Veriut nga BE


Partnerët më të rëndësishëm tregtar të Republikës të Maqedonisë së Veriut nga BE, të cilët vitet e fundit i marrin pesë vendet e para, janë pasqyruar në grafikët 2 dhe 3. Aty janë shqyrtuar partnerët vetëm nga BE për shkak të fokusit të analizës të tregtisë me Mbretërinë e Bashkuar që është rregulluar me MSA. Është evidente se Gjermania, Greqia dhe Italia janë tradicionalisht partnerë të rëndësishëm në të gjithë periudhën e analizuar, kurse nga viti 2007, prani të rregullt në pesë partnerët tregtarë nga BE ka edhe Bullgaria. Këto katër vende janë në mënyrë të barabartë të rëndësishme edhe në import edhe në eksport. Përveç tyre, **si partner i rëndësishëm nga ana e importit nga viti 2010 paraqitet Mbretëria e Bashkuara**, kurse në anën e eksportit, një destinacion i rëndësishëm i eksportit në pesë vitet e fundit është e Belgjika, por paraqiten edhe Sllovenia, Kroacia, Holanda, Franca, etj.¹⁹

Nga ana e importit, pesë partnerët më të rëndësishëm tregtar maqedonas nga BE marrin pjesë me rreth dy të tretat (2/3) në importin e përgjithshëm maqedonas nga BE, përderisa në anën e eksportit rreth tre të katërtat (¾) nga importi maqedonas plasohet në pesë destinacione nga BE. Kjo tregon se Republika e Maqedonisë ka numër shumë të vogël të partnerëve strategjik tregtar, që rezulton me varësi të lartë të tregtisë nga ato.

Partner më i lartë tregtarë i Republikës të Maqedonisë së Veriut është Gjermania. Ajo në vitin 2019 ka absorbuar rreth 48,7% nga importi i përgjithshëm maqedonas, kurse ka marrë pjesë me 11,3% në importin e përgjithshëm maqedonas.²⁰ Në lidhje me eksportin/importin maqedonas nga BE, numrat ende janë më të mëdha. Pjesëmarrja e Gjermanisë ka qënë 60% dhe 18% në importin/eksportin e përgjithshëm në/nga BE në vitin 2019, në mënyrë përkatëse. Kjo tregon se marrëdhëniet tregtare me Gjermaninë janë kryesore për Republikën e Maqedonisë dhe se duhet të punohet vazhdimisht në avancimin e tyre.

GRAFIKU 2.

Partnerët më të rëndësishëm tregtar nga BE për Republikën e Maqedonisë së Veriut – import
(në mijëra euro)




¹⁹ Belgjika është vazhdimisht e pranishme nga viti 2014 në pesë të parat, është përfshirë në grafikun 3.

²⁰ Njoftimi nr.7.1.20.02:Shkëmbimi i mallrave me shtetet e huaja, janar – dhjetor 2019, Enti shtetëror për statistika, shkurt 2020



GRAFIKU 3.

Partnerët më të rëndësishëm tregtar nga BE në Republikën e Maqedonisë së Veriut (në '000 euro)



Në grafikun 3 vërehet dinamika e zhvillimit të eksportit maqedonas në Gjermani, i cili nga viti 2010 ka trend të rritjes të fuqishme dhe të vazhdueshme. Kjo është kryesisht për shkak të eksportit nga IHD sepse shumica e kompanive të huaja në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pavarësisht prej ku rrjedh investuesi, kanë depot dhe qendrat e shpërndarjes në Gjermani, ashtuqë eksporti shkon në Gjermani. Kjo nuk është kështu në anën e eksportit, respektivisht ai më shpesh kryhet drejtëpërdrejtë nga vendi prej ku rrjedh firma (IHD) apo lënda e parë. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e Gjermanisë në anën e eksportit maqedonas është shumë më pak se sa në anën e importit.

Në anën e importit (grafiku 2), ndryshimi më i rëndësishëm që është bërë si rezultat i IHD në Republikën e Maqedonisë është pozicionimi i Mbretërisë të Bashkuar si një nga vendet më të rëndësishme të importit nga viti 2011 e këndej. **Pjesëmarrja e Mbretërisë të Bashkuar ka qënë 11.5% në importin e përgjithshëm maqedonas dhe 18.4% në importin nga BE në vitin 2019.²¹ Mbretëria e Bashkuar zakonisht është në vendin e dytë në importin e përgjithshëm, menjëherë pas Gjermanisë. Megjithatë, në vitin 2019 e ka marrë vendin e parë, respektivisht pjesa më e madhe nga importi maqedonas është bërë nga ky vend. Në anën e eksportit, Mbretëria e Bashkuar ka marrë pjesë me 2.2% në importin e përgjithshëm maqedonas dhe 2.8% në importin maqedonas në BE në vitin 2019. Me këtë pjesë, Mbretëria e Bashkuar është në vendin e 11 në destinacionet eksportuese maqedonase. Kjo tregon se Mbretëria e Bashkuar është shumë më e rëndësishme për Republikën e Maqedonisë së Veriut në aspekt të importit. Në kontekst të lëndës të hulumtimit në këtë studim, analiza e detajuar e tregtisë sipas produkteve ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar siguron informacione shtesë për rëndësinë e këtij vendi për importin maqedonas.**

²¹ Ibid.



1.3. Struktura e tregtisë të jashtme maqedonase

Me qëllim që të fitojmë një fotografi respektivisht pasqyrë më të qartë për tregtinë e jashtme maqedonase, është dhënë një pasqyrë e importit dhe eksportit të Republikës të Maqedonisë së Veriut sipas sektorëve/segmenteve. Të dhënat i referohen importit dhe eksportit të përgjithshëm, sipas disponueshmërisë të tyre nga enti shtetëror për statistika. Megjithatë, duke patur parasysh pjesëmarrjen e lartë të BE në importin dhe eksportin e përgjithshëm maqedonas, të dhënat mund të konsiderohen si relevante edhe në lidhje me tregtinë me BE.

Importi në sektorë. Në grafikun 4 është paraqitur importi i produkteve maqedonase në sektorë, sipas Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Tregtisë (KNST). Në analizë janë marrë segmentet e KNST (pjesë nga sektorët) me qëllim që të fitohet një fotografi më e hollësishme për gjendjen e importit. Nga të dhënat mund të shihet qartë se importi maqedonas karakterizohet me ndryshime në strukturë në disa vitet e fundit. Sipas KNST, importi më i madh deri në vitin 2013 është bërë në segmentin “Naftë dhe prodhimet e naftës”, duke patur parasysh varësinë e shtetit nga këto produkte nga jashtë vendit. Të dhënat janë dhënë për vitet e zgjedhura nga periudha 2007–2018. Ky segment ka patur pjesëmarrje prej 13.6% në importin e përgjithshëm të vendit në vitin 2010, kurse më pas pjesëmarrja relativisht bie (7% në vitin 2018), megjithatë jo aq shumë për shkak të zvogëlimit të vlerës absolute të këtij importi, por për shkak të rritjes të importit në segmentet tjera. **Nga viti 2010 filloni ngritja e rritjes të importit të metaleve të lyera dhe ky segment nga viti 2014 e merr pozitën udhëheqëse në anën e importit maqedonas. Rritja e tij është për shkak të importimit të lëndëve të para të nevojshme për prodhimin e IHD, sidomos platiniumit dhe paladiumit për prodhimin e katalizatorëve të kompanisë britanike “Xhonsen Meti”.**

Dy segmentet tjera që ndodhen në pesë të parat në anën e importit janë makineritë elektrike dhe tekstili. Importi i segmentit “Makineri elektrike” është rritur nga 117.8 milion euro në vitin 2007 (3% nga importi i përgjithshëm) në 716 milion euro në vitin 2018 (9.3% nga importi i përgjithshëm), që në masë të madhe është për shkak të importit të pajisjeve në vend, siç janë IHD, si dhe për kompanitë vendore. Segmenti tjetër – “Tekstil, fije dhe të ngjajshme” është rritur nga 8.3% në vitin 2007 në 6% në vitin 2018, edhe pse importi në vlera absolute është rritur, megjithatë dinamika e rritjes është më e ulët nga ajo e importit të përgjithshëm.


Segmentet tjera të cilat në tre vitet e fundit kanë vlerë të ngjajshme të importit janë “Hekuri dhe çeliku” dhe “Përpunimet nga mineralet jometalike”. Pjesëmarrja e tyre në vitin 2018 ka qënë 5.9% dhe 5.7% në importin e përgjithshëm, respektivisht. Në nëntë segmentet më të rëndësishme të importit nuk ndodhet asnjë bujqësorë sepse ata kanë vlerë shumë më të vogla të importit. Prej tyre, import më të lartë kanë segmentet “Mishi edhe përpunimet e mishit” dhe “Pemët dhe perimet” pjesëmarrja e të cilave ka qënë 1.8% dhe 1.2 në importin e përgjithshëm, respektivisht.

Nëse importi në sektorë shihet në dritën e MSA, është me rëndësi regjimi asimetrik për zvogëlimin e doganave për produktet nga BE në tregun maqedonas. Eliminimi i shkallëzuar i doganave nga 10% në



GRAFIKU 4.

Segmentet e KNST me import më të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut
(në miliona euro)



vjet për produktet nga BE ka patur për qëllim që të arrihet tregti pa dogana në vitin 2011, me përjashtim të produkteve të çelikut për të cilat është përcaktuar periudhë më e shkurtër nga 5 vite (deri në vitin 2006) dhe për disa produkte bujqësore dhe mallra të ndryshme që janë lëndë e rregullimit të ndërsjellë. Të dhënat tregojnë rritje të importit në pothuajse të gjithë sektorët deri në vitin 2008, që pjesërisht është për shkak të zvogëlimit të shkallëzuar të doganave me çrast produktet nga BE janë bërë më të lira për kompanitë maqedonase. Valë tjetër e rritjes të importit kishte nga viti 2010 e këndej, kryesisht për shkak të aktiviteteve të IHD në vend.

Importi sipas produkteve. Krahas sipas sektorëve / segmenteve, është me rëndësi të shihet importi i Republikës të Maqedonisë së Veriut sipas produkteve. Në pajtim me ndryshimet të importit sipas sektorëve / segmenteve, **në strukturën sipas produkteve në disa vite të fundit dominojnë pesë produkte – platiniumi, nafta dhe përpunimet nga nafta; produktet e qeramikës për përdorim laboratorik, kimik apo përdorim tjetër teknik; Paladiumi dhe produktet e çelikut.** Produkti kryesor – platiniumi ka marrë pjesë në importin maqedonas me rreth 7,7% në vitin 2018. Pesë produktet e theksuara kanë marrë pjesë me rreth 22.3% në importin e përgjithshëm të Republikës të Maqedonisë së Veriut në vitin 2018.



Importi sipas sektorëve/segmenteve. Në grafikun 5 është paraqitur eksporti i produkteve maqedonase sipas Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Tregtisë (KNST). Janë paraqitur segmentet (pjesë nga sektorët e KNST) të cilët më së shumti eksportojnë nga Republika e Maqedonisë së Veriut. Sipas klasifikimit KNST, segmentët kryesorë eksportues maqedonas deri në vitin 2013 kanë qënë tekstili dhe metali. Pastaj, kryesore janë "Produktet kimike", kryesisht si rezultat i prodhimit dhe eksportit nga IHD.

Siç është paraqitur në grafikun 5, tekstili (veshjet) dhe industria e hekurit dhe çelikut një kohë më të gjatë kanë qënë veprimet kryesore eksportuese. Në vitin 2007, veshjet kanë marrë pjesë me 19,3% në eksportin e përgjithshëm, me tendencë të rënies të vazhdueshme deri në 7,8% në vitin 2018. Kjo është për shkak të rritjes të sektorëve tjerë sepse në vlera absolute, ky segment është relativisht stabil dhe nuk ka rritje të madhe. Segmenti i metalit, ka dominuar në eksportin maqedonas në periudhën 2005-2014, me pjesëmarrje më të lartë prej 37.3 në eksportin e përgjithshëm maqedonas në vitin 2007. Nga viti 2011 deri në vitin 2016, ky segment përjeton një zvogëlim të vazhdueshëm, që kryesisht është për shkak të zvogëlimit të çmimeve të metalit në tregjet botërore (2012 – 2015) si dhe problemet në funksionimin e "Fenit", një nga prodhuesit më të mëdhenj në këtë sektor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përmirësimi i trendit është vërejtur në vitin 2017 dhe në vitin 2018.

Ndryshimet negative në sektorin e metaleve, si dhe zgjerimi i prodhimtarisë të IHD të sapohura në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kryesisht në industrinë automobilistike, ka rezultuar në ndryshimin e strukturës të eksportit, me atë që **segmenti "Materiale kimike dhe produkte" ka marrë pozitën udhëheqëse. Rritja e sektorit ka filluar nga viti 2010 kur vlera e eksportit ka qënë 172 milion euro apo 6.8% nga eksporti i përgjithshëm. Në vitin 2018 numrat përkatëse janë 1.2 miliard euro apo 21% nga eksporti maqedonas.**


Dy segmente tjera të rëndësishme të eksportit janë "Makinat industriale për përdorim të përgjithshëm" dhe "Makinëritë elektrike dhe aparatet". Të dy segmentet shënojnë rritje më intensive të eksportit nga viti 2013 e kënde, që kryesisht i referohet IHD "të gjelbërta" sepse disa prej kompanive prodhojnë dhe eksportojnë produkte që klasifikohen në këto segmente. Pjesëmarrja e këtyre dy segmenteve në eksportin e përgjithshëm në vitin 2018 ka qënë 11.2% dhe 14.4%, respektivisht. Krahës sektorëve industrial, nga segmentet bujqësore të rëndësishme për eksportin janë "Pemët dhe perimet" dhe "Duhani dhe përpunimet nga duhani". Pjesëmarrja e tyre në eksportin e përgjithshëm ka qënë 2,5% dhe 2.2% respektivisht, që nuk është e lartë, megjithatë është e rëndësishme në kontekst të eksportit të prodhimeve bujqësore nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Përderisa eksporti sipas sektorëve shihet në dritën e MSA, duhet të thekoshet se të dy sektorët që tradicionalisht janë eksportues dhe kohë më të gjatë kanë dominuar në eksportin maqedonas – tekstili dhe metali, janë rregulluar me protokolle të veçanta të MSA. Në Protokollin I (Tekstil dhe produkte të tekstilit) dhe Protokollin II (produkte të çelikut) është paraparë që doganat për produktet maqedonase në tregun e BE të eliminohen menjëherë, kurse të zbatohet zvogëlimi i shkallëzuar i doganave për importin



GRAFIKU 5.

Segmentet – KNST me eksport më të lartë nga Republika e Maqedonisë së Veriut
(në miliona euro)



nga BE të produkteve të tekstilit dhe të çelikut në periudhë prej 10 dhe 5 vitesh, respektivisht. Kjo do të thotë se industria maqedonase e tekstilit dhe e metalit një periudhë të caktuar kohore kanë qënë të mbrojtura në tregun e brendshëm, kurse kanë patur qasje të pandërprerë në tregun e BE nga vetë fillimi. Sektorët tjerë janë rregulluar me rregulla të përgjithshme tregtare, duke parashikuar një regjim asimetrik për të cilin është diskutuar më lartë, kurse mbrojtja është zbatuar në një pjesë të produkteve bujqësore dhe produkteve tjera të ndjeshme.

Eliminimi i doganave dhe kufizimeve kuantitative gjithsesi se kanë qënë tërheqëse për kompanitë maqedonase, megjithatë eksporti është përcaktuar (dhe kufizuar) nga niveli i zhvillimit të industrisë në vend. Në fakt, eksporti në tregun nga BE pa dogana është kushtëzuar nga përmbushja e kërkesave të BE për cilësi dhe standardizim të produkteve. Gjatë nënshkrimit të MSA, dy sektorët dominant në industrinë maqedonase tashmë kanë eksportuar në tregun e BE, përderisa industritë tjera nuk ishin mjaftueshëm konkurrense që të konkurojnë në atë treg. Në atë kuptim, nevojiteshin investime që të ngrihet kapaciteti



i vendit që të eksportojnë në tregun e BE. Për fat të keq, investimet e brendshme kanë mbetur në nivel të ulët, megjithatë MSA mund të llogaritet si faktor për tërheqjen e IHD në vend sepse qasja e hapur në tregun e BE i ka siguruar pozitë më të mirë në Republikën e Maqedonisë së Veriut të investitorët e huaj. Kjo është vërtetuar me hyrjen e MSA në vend, që ka kontribuar për rritjen e eksportit maqedonas në BE, kurse në këtë mënyrë, edhe për përdorim më të gjërë të MSA.

Eksporti sipas produkteve. Krahas sipas sektorëve/segmenteve, me rëndësi është të shihet importi i Republikës të Maqedonisë së Veriut sipas eksporteve. **Në strukturën e importit sipas produkteve në disa vite të fundit dominojnë pesë produkte – katalizatorët e mbajtësve të metaleve të çmuara apo bashkëdyzimet e tyre, feronikeli, produktet nga hekuri dhe çeliku (produktet e mbështjella) veshjet dhe përpunimet nga nafta.** Produkti kryesorë, katalizatorët e mbajtësve me metalet e çmuara apo bashkëdyzimet e tyre, kanë dominuar larg prej të gjithë produkteve tjera. Vetëm ky produkt ka marrë pjesë në eksportin maqedonas me rreth 17% në vitin 2018, prej të cilave 98,6% janë eksportuar në Gjermani, kurse një pjesë e vogël në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Poloni. Pesë produktet e theksuara kanë marrë pjesë me rreth 42.8% në eksportin e përgjithshëm të Republikës të Maqedonisë së Veriut në vitin 2018. Kjo tregon një përqëndrim jashtëzakonisht të lartë dhe varësi të eksportit nga disa produkte. Siç është diskutuar më parë, ndryshimi në strukturën e eksportit është për shkak të IHD në industrinë automobilistike. Ky ndryshim ka treguar se transformimi i tillë i tregtisë është i mundshëm për një kohë shumë të shkurtër, por duhet të shoqërohet edhe me politika përkatëse në fushat tjera. Rrjedhimisht, është e domosdoshme ndjekja e vazhdueshme e strukturës tregtare nga ana e krijuesve të politikave me qëllim të ndërmarrjes në kohë të masave për zvogëlimin e rreziqeve, respektivisht nxitjen e investimeve në sektorë të ndryshëm të orientuar kah eksporti.





2.

Analiza e tregtisë të jashtme ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar

Tregtia e Republikës të Maqedonisë së Veriut me Mbretërinë e Bashkuar në dekadën e fundit karakterizohet me një import të lartë dhe eksport të ulët.²² Nga tabela 1 qartazi shihet se **Mbretëria e Bashkuar është një partner shumë më i rëndësishëm i Republikës të Maqedonisë së Veriut në anën e importit. Kjo ka rezultuar me një deficit të lartë tregtar, i cili veçanërisht është thelluar në vitin 2019, kur ka qënë 825 milion euro.**

TABELA 1.

Tregtia e Republikës të Maqedonisë së Veriut me Mbretërinë e Bashkuar (mijëra euro)

Emri/përshkrimi	2007	2010	2013	2016	2017	2018	2019
Eksporti	55626	44670	60876	54589	69939	102596	143618
Importi	38605	214992	547027	655270	691200	729557	969098
Bilansi tregtar	17020	-170322	-486151	-600681	-621261	-626961	-825480

Burimi: Enti shtetëror për statistika – baza MAKSTAT

Me qëllim që të fitohet një fotografi më e hollësishme për tregtinë e Republikës e Maqedonisë së Veriut me Mbretërinë e Bashkuar, më poshtë janë paraqitur importi dhe eksporti në nivel të produkteve. Është bërë përzgjedhje për prezantimin e rrjedhave tregtare sipas produkteve, dhe jo sipas sektorëve sepse struktura sipas produkteve është shumë më relevante në raport me tregtinë ndërmjet dy palëve.

²² http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat...NadvoresnaTrgovija...KumulativniPod/125_zemji_kumulativ_ml.px/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef



2.1. Struktura e importit maqedonas nga Mbretëria e Bashkuar sipas produkteve

Analiza e importit të Republikës të Maqedonisë së Veriut nga Mbretëria e Bashkuar është bërë sipas produkteve, sipas sistemit të harmonizuar të nomenklaturës (SHN) dhe sistemit tarifor, për shkak të përqëndrimit të lartë të importit në disa produkte. Është përfshirë periudha 2007-2019, për vite të zgjedhura me qëllim që të vërtetohet trendi i lëvizjes të importit. Si vit fillimi është zgjedhur viti 2007 kur Mbretëria e Bashkuar ende nuk ka qënë partner tregtar i rëndësishëm për Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim që qartazi të shihen ndryshimet e mëtutjeshme. Tre produkte – **platinum, paladium dhe uranium (legura)** tregojnë dinamikë të lartë të rritjes edhe në periudhën 2010 – 2018 është shënuar rritje e pjesëmarrjes të tyre të kombinuar në importin e përgjithshëm maqedonas nga 4.1% në 8.6%. Rritje shtesë në 10,4% është evidentuar në vitin 2019. Në vitin 2007 nuk ka patur import në asnjë prej këtyre produkteve.

Në tabelën 2 janë paraqitur dhjetë produktet më të rëndësishme të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut i importon nga Mbretëria e Bashkuar, të klasifikuara sipas shenjave tarifore dhe SH.²³ Siç është përmendur më lartë, **produktet më të importuara janë platinumi, paladiumi, dhe uraniumi (legura), të cilat e pozicionojnë Mbretërinë e Bashkuar si një nga partnerët më të rëndësishëm strategjik në Republikën e Maqedonisë së Veriut në anën e importit** (Grafiku 3). Këto tre produkte kanë marrë pjesë me reth 80% në importin maqedonas nga Mbretëria e Bashkuar në vitin 2010, me trend të rritjes deri në 89.4% në vitin 2018 dhe 90.7% në vitin 2019. Në vlerë absolute, importi i këtyre tre produkteve është rritur nga 170.6 milion euro (2010) në 651.9 milion euro (2018) dhe 879 milion euro (2019).

Pavarësisht se Gjermania është zakonisht partneri kryesor në anën e importit një kohë më të gjatë, sipas vlerës kumulative, Mbretëria e Bashkuar është më e rëndësishme në raport me strukturën e importit sipas produkteve. Krahës kësaj, në vitin 2019 Mbretëria e Bashkuar ka marrë vendin e parë në anën e importit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Është arritur një rritje e lartë vjetore prej 32% në importin e këtij vendi në vitin 2019, që është tregues për rëndësinë rritëse të Mbretërisë të Bashkuar për tregtinë e jashtme maqedonase. Është e pritshme që ky trend në rritje të ndërpritet në vitin 2020, si pasojë e tregtisë të kufizuar për shkak të Covid-19. Pas normalizimit të gjendjes, tregtia mund të revitalizohet relativisht shpejtë, por duhet të merret parasysh se kryesisht bëhet fjalë për import dhe eksport nga industria automobilistike, kurse parashikimet për këtë degë të industrisë janë se do të rikuperohet më ngadalë. Sidoqoftë, IHD tani për tani mbetet mbështetje për Republikën e Maqedonisë së Veriut, që udhëzon në atë se Mbretëria e Bashkuar do të mbetet edhe më tutje e rëndësishme për shkëmbimin e jashtëm maqedonas tregtar.

Krahës tri produkteve kryesore, në tabelën 2 janë paraqitur edhe shtatë kategori tarifore që importohen nga Mbretëria e Bashkuar, pjesëmarrja e kombinuar e të cilave në importin e përgjithshëm maqedonas ka qënë 3% në vitin 2019. Kjo do të thotë se pjesëmarrja e dhjetë produkteve më të importuara maqedonase nga Mbretëria e Bashkuar në importin e përgjithshëm maqedonas ka qënë reth 13.5% në vitin 2019.

²³ <http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef>



TABELA 2.

Importi në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga Mbretëria e Bashkuar sipas produkteve
(në mijëra euro dhe përqindje)

Nr.	Shenja tarifore	Emri/përshkrimi	2007	2010	2013	2016	2017	2018	2019
1.	7110110000	Platinum: I papërpunuar apo në pluhur	0	73414	303847	464504	441780	396225	398702
		Pjesëmarrje në importin e përgjithshëm të RMV	0.0	1.8	61	7.5	6.5	5.2	4.7
		Pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga MB	0.0	34.15	55.55	70.89	63.96	54.31	41.1
2.	7110210000	Paladium: I papërpunuar apo në pluhur	0	9931	89279	116476	167402	218687	377877
		Pjesëmarrje në importin e përgjithshëm të RMV	0.0	0.2	18	1.9	2.5	2.9	4.5
		Pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga MB	0.0	4.6	16.3	17.8	24.2	30.0	39.0
3.	2843909000	Uraniumi, natyral dhe bashkëdyzimet e tij; legura	0	87300	40787	10093	16374	36964	102290
		Pjesëmarrje në importin e përgjithshëm të RMV	0.0	2.1	0.8	0.2	0.2	0.5	1.2
		Pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga MB	0.0	40.61	7.46	1.54	2.37	5.07	10.6
4.	5903209000	Pëlhura të tekstitil të ngopura, të lyera, të mbuluara apo laminuara me masë plastike, përveç atyre me nr. tar 5902: Me poliuretan	55	313	2875	2160	4884	6746	3743
5.	7804190000	Pltaka, fletë metalike, shirita dhe foli: tjetër	0	0	605	5373	5239	5857	5698
6.	5903109000	Pëlhura tekstili të ngopura, të lyera, të mbuluara, apo laminuara me masë plastike, përveç atyre me nr.tar 5902: Me polivinil kloruri	7	1	7	14	739	2833	3072
7.	5211320000	Pëlhure prej pambuku, me përmasa më pak se 85% të masës pambuk, të përziera kryesisht apo vetëm me fije artificiale apo sintetike, me masë më të madhe se 200 g/m2. Të ngjyrosura. Pëlhurë pambuku me vija diagonale me tre apo katër fije, duke përfshirë edhe pëlhurat e pambukut me fije të kryqëzuara	0	1175	1853	2090	2068	1926	2310
8.	3307200000	Deodorant për përdorim personal dhe preparate kundër djersitjes	370	786	1031	1380	1258	1856	2107
9.	2106909800	Produktet ushqimore që nuk janë përmendur apo përfshirë në vend tjetër: tjetër	96	607	833	1654	1680	1759	1972
10.	3926909790	Produkte tjera nga masa plastike, tjetër	400	235	294	631	1095	1640	1173

Burimi: Enti shtetëror për statistika – baza MAKSTAT



TABELA 3.

Eksporti nga Mbretëria e Bashkuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas produkteve
(në mijëra euro dhe përqindje)

Nr.	Shenja tarifore	Emri/Përshkrimi	2007	2010	2013	2016	2017	2018	2019
1.	7110110000	Platinumi: I papërpunuar apo në pluhur (eksport në MV)	0	103169	264101	614686	627117	591411	583083
		Pjesëmarrje në eksport në MV në eksportin e përgjithshëm britanik të 7110110000	0.0	13.5	20.8	44.6	43.0	51.7	62.4
2.	7110210000	Paladiumi: I papërpunuar apo në pluhur (import në MV)	0	13382	77343	130511	220530	275442	663224
		Pjesëmarrje në eksportin e MK në eksportin e përgjithshëm britanik të 7110210000	0.0	2.8	8.2	10.5	16.1	19.6	27.6
3.	2843909000	Uraniumi, natyral dhe bashkëdyzimet e tij; legurat (eksport në MV)	0	113444	112472	18131	16064	34640	82814
		Pjesëmarrje në eksportin në MV në eksportin e përgjithshëm britanik të 2843909000	0.0	17.6	34.7	7.0	6.5	10.2	19.4
4.	7804190000	Pllaka, fletë metalike, shirita, dhe foli: tjetër (eksport në MV)	0	0	599	5060	4914	5532	5297
		Pjesëmarrje në eksportin në MV në eksportin e përgjithshëm britanik të 7804190000	0.0	0.0	2.3	12.9	13.8	11.8	12.7
5.	2208307100	Alkohol etilik i pa denatuar me përmbajtje alkoholi më të vogël se 80%; dhe raki, liker dhe pije tjera alkoholike ... (eksport në MV)	0	195	0	332	2264	3080	1171
		Pjesëmarrja në eksport në MV në eksportin e përgjithshëm britanik të 2208307100	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.03



Nr.	Shenja tarifore	Emri/Përshkrimi	2007	2010	2013	2016	2017	2018	2019
6.	5903209000	Pëlhura tekstili të ngopura, të lyera... (eksport në MQ)	0	20	65	1482	3506	3200	/
		Pjesëmarrja në eksportin në MV në eksportin e përgjithshëm britanik të 5903209000	0.0	0.0	0.1	1.3	3.3	4.7	/
7.	3923101000	Paketa, sandëqe, arka dhe produkte të ngjajshme nga plastika, për transport apo paketim të gjysëm produkteve nga vafël, maska apo thjerëza optike (eksport në MV)	0	0	0	0	31	2261	2303
		Pjesëmarrja në eksportin në MV në eksportin e përgjithshëm britanik të 3923101000	0.0	0.0	0.0	0.0	0.02	1.6	1.5
8.	2616100000	Miniera argjendi dhe koncentre (eksport në MV)	0	0	0	692	1256	1557	0
		Pjesëmarrja në eksportin në MV në eksportin e përgjithshëm britanik të 2616100000	0.0	0.0	0.0	33.3	79.5	70.2	0.0
9.	4907003000	Banknota (eksporti në RMV)	0	0	0	0	0	1474	/
		Pjesëmarrja në eksportin në MV në eksportin e përgjithshëm britanik të 4907003000	0.0	0.0	0.	0.00	0.0	17	/
10.	8479907000	Makineri dhe pajisjet mekanike me funsione të veçanta, që nuk janë përmendur në vend tjetër, përveç të hekurit dhe çelikut (eksport në MV)	0	0	0	0	1823	1169	/
		Pjesëmarrja në eksportin në MV në eksportin e përgjithshëm britanik të 8479907000	0.0	0.0	0.0	0.0	0.8	0.5	/

Burimi: ITC TRADEMAP database²⁴

²⁴ www.trademap.org, është qasur në datë 10.5.2020.



Kjo është një pjesë e rëndësishme, megjithatë struktura tregon se importi nga Mbretëria e Bashkuar bëhet në numër të kufizuar të kategorive tarifore. Në tabelën 2 janë dhënë të dhënat për pjesëmarrjen e tre produkteve të para në importin e përgjithshëm maqedonas dhe importi nga Mbretëria e Bashkuar. Kjo nuk është bërë për produktet tjera për shkak të vlerës të tyre të ulët.

Me qëllim që të përcaktohet se sa janë të rëndësishme produktet e paraqitura në tabelën 2 për anën britanike, është bërë analizë e importit nga Mbretëria e Bashkuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në tabelën 3 janë dhënë të dhënat për importin e përgjithshëm nga Mbretëria e Bashkuar sipas numrit tarifor për dhjetë produktet më të importuara britanike në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe është bërë llogaritje për pjesëmarrjen në importin britanik të kategorisë të caktuar tarifore në Republikën e Maqedonisë së Veriut në eksportin e përgjithshëm britanik për atë kategori. Janë përdorur të dhënat nga baza e të dhënave INTRACEN të Qendrës ndërkombëtare të tregtisë.²⁵ **Gjatë kontrollit të kryqëzuar të të dhënave është vërtetuar se lista e produkteve më të importuara nga Mbretëria e Bashkuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut (tabela 3) nuk përputhet në tërësi me listën e produkteve më të importuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga Mbretëria e Bashkuar (tabela 2).** Në të njëjtën kohë, janë bërë edhe kontrollet shtesë edhe me të dhënat të cilat për Republikën e Maqedonisë së Veriut gjenden në bazën INTRACEN dhe sërish nuk ka përputhje. Të dhënat nga baza INTRACEN për Republikën e Maqedonisë së Veriut në masë të madhe përputhen me të dhënat nga baza – MAKSTAT.

Në lidhje me dallimet në listën e produkteve të paraqitur në tabelën 2 dhe tabelën 3, nevojitet një aktivitet i përbashkët nga ana e administratave doganore dhe statistikave zyrtare të të dy palëve (maqedonase dhe britanike) për përcaktimin e arsyeve për këto dallime dhe heqjen e tyre. Asimetria në të dhënat statistikore në dy shtete të cilat tregtojnë ndërmjet veti është një dukuri e shpeshtë në tregtinë ndërkombëtare. Mund të ekzistojnë arsye të ndryshme për këtë dukuri, kurse në nivel të produkteve, diskrepanca mund të rrjedhë nga përdorimi i klasifikimeve të ndryshme të produkteve gjatë eksportit dhe importit.²⁶

Nga krahasimi i tabelave 2 dhe 3, mund të vërehet se pesë nga dhjetë produktet paraqiten në të dy anët. Krahas dallimeve në produkte, është me rëndësi të theksohet se ka dallime edhe në vlerat absolute të produkteve në evidencën e të dy palëve, që të disa prej produkteve është shumë e madhe. Është e rëndësishme që tre produktet kryesore janë të njëjta, megjithatë edhe te ato ka dallime domethënëse në vlerat absolute. Në të njëjtën kohë, nëse ka dallim, ai është i arsyeshëm nëse vlera në vendin e importit është më e lartë për shkak të shpenzimeve të transportit dhe shpenzimeve tjera.²⁷ Këtu rasti është anasjelltas, respektivisht pala britanike tregon eksport të platinumit në vitin 2018 prej 591 milion eurove kundrejt importit prej 396 milion eurove në MV. Edhe te produktet tjera është e njëjta, respektivisht vlerat britanike gjatë eksportit janë më të larta sesa gjatë importit në MV të produkteve të njëjta.

²⁵ www.trademapp.org është qasur në datë 10.05.2020.

²⁶ https://ec.europa.eu/eurostat/documents/7828051/8076585/Asymmetriec_trade_goods.pdf

²⁷ Si i arsyeshëm konsiderohet dallimi prej 10-20% vlerë më të madhe gjatë importit krahasuar me eksportin.



Dallimet në evidencën statistikore gjithmonë merren si një rethanë kufizuese në ndërtimin e politikës përkatëse tregtare. Në rastin e tregtisë ndërmjet dy vendeve, është me rëndësi që përputhen tre produktet kryesore. Sidoqoftë, **në raport të ndërtimit të politikës të qëndrueshme tregtare të drejtuar kah zgjerimi i strukturës të produkteve nevojitet që të sqarohen dallimet statistikore.**

Siç mund të vërehet nga tabelat 2 dhe 3, tre produktet më të rëndësishme në tregtinë ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar janë të njëjtat edhe për të dy palët. **Këto tre produkte – platiniumi, paladiumi dhe uraniumi (legura) marrin pjesë në eksportin britanik nga 0.7% deri në 0.9% në vjet.** Kjo është pjesëmarrje e vogël, megjithatë duhet të kihet parasysh se tregtia britanike është shumë e lartë sipas vëllimit dhe përbëhet nga shumë produkte. Për këtë arsye, **nevojitet që të angazhohet pjesa e eksportit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në eksportin e përgjithshëm britanik në secilën prej kategorive të theksuar tarifore.** Llogaria tregon se kjo pjesëmarrje është veçanërisht e lartë te platiniumi dhe ka qënë 62.4% në vitin 2019, kurse tek paladiumi dhe uraniumi (legura) ka qënë 27.6% dhe 19.4%, **respektivisht.** Produktet tjera britanike eksporti i të cilave në Republikën e Maqedonisë së Veriut është gjithashtu domethënës për Mbretërinë e Bashkuar janë pllakat, fletët metalike, shiritat dhe folitë. Ky eksport sipas vëllimit nuk është i madh, megjithatë 12.7% prej tij realizohet në tregun maqedonas. Gjithashtu, pjesëmarrje veçanërisht të rëndësishme në eksportin britanik të minierave të argjendit dhe koncentrateve në vitin 2018 ka patur pjesa që është eksportuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut (70% në vitin 2018), megjithatë ky eksport është mjaftë i vogël në vlerën absolute, kurse në vitin 2019 nuk ka aspak eksport.

Të dhënat e paraqitura në tabelën 3 tregojnë se **Republika e Maqedonisë së Veriut është mjaftë e rëndësishme për palën britanike në lidhje me eksportin e tre produkteve kryesore – platinium, paladium dhe uranium (legura).** Ky eksport nga Mbretëria e Bashkuar është lidhur me IHD britanike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kurse lidhja e këtillë e investimeve dhe tregtisë zakonisht nënkupton një interes shumë më të madh te vendi që investon për sigurimin e kushteve të papenguara (dhe sa më shumë që mundet) të tregtisë të firmave të saj, se sa kur do të punojë për tregtinë që nuk është e lidhur me IHD. Rrjedhimisht, interesi për platformë të mirë tregtare pas bregzit është njësoj i rëndësishëm edhe për Mbretërinë e Bashkuar edhe për Republikën e Maqedonisë së Veriut.



2.2. Struktura e eksportit maqedonas në Mbretërinë e Bashkuar sipas produkteve

Analiza e eksportit nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Mbretërinë e Bashkuar është bërë sipas produkteve, duke ndjekur shembullin e analizës të importit. Edhe kjo analizë është bërë për periudhën 2007-2019, për vite të zgjedhura, me qëllim që të sigurohet krahasueshmëria e të dy palëve – importit dhe eksportit. Të dhënat janë marrë nga baza – MAKSTAT²⁸ të Entit shtetërorë për statistika.

Në tabelën 4 janë paraqitur dhjetë produktet më të rëndësishme të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut i eksporton në Mbretërinë e Bashkuar, të klasifikuara sipas shenjave tarifore. Dominojnë katër produkte: **Ulëset, katalizatorët, zgjyra, hiri dhe skrap i dhe puror, cigarillosat dhe cigaret. Ata kanë marrë pjesë me rreth 42% dhe 53.6% në eksportin maqedonas në Mbretërinë e Bashkuar në vitet 2018 dhe 2019. Megjithatë, pjesëmarrja e tyre kumulative në eksportin e përgjithshëm maqedonas ka qënë nën 1% në vitin 2018, kurse rreth 1.2% në vitin 2019.**

Pjesëmarrja kumulative është e ulët, megjithatë, siç është përmendur më lartë, **për shkak të vendosjes organizative të kompanive të huaja nga Mbretëria e Bashkuar të cilat importojnë lëndë të para nga shteti domicil, kurse produktet e gatshme i eksportojnë në Gjermani, të dhënat në faqen e eksportit duhet të shqyrtohen nga aspekti i fotografisë më të gjërë. Në fakt, kontributi i firmave me prejardhje britanike është kryesisht i madh në eksportin e përgjithshëm maqedonas, edhe pse kjo nuk reflektohet në eksportin e drejtëpërdrejtë nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Mbretërinë e Bashkuar.**

Me qëllim që të përcaktohet se sa është rëndësia e produkteve të paraqitura në tabelën 4 për palën britanike, është bërë analizë e eksportit të produkteve maqedonase në Mbretërinë e Bashkuar. Janë përdorur të dhënat nga baza e të dhënave INTRACEN të Qendrës ndërkombëtare të tregtisë.²⁹ Gjatë kontrollit të kryqëzuar të të dhënave është përcaktuar se lista e produkteve më të eksportuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Mbretërinë e Bashkuar (tabela 4) nuk përputhet tërësisht me listën e produkteve më të eksportuara maqedonase në Mbretërinë e Bashkuar (tabela 5). Në të njëjtën kohë, janë bërë kontrollat shitesë edhe me të dhënat të cilat për Republikën e Maqedonisë së Veriut gjenden në bazën INTRACEN dhe sërish nuk ka përputhje. Të dhënat nga baza INTRACEN për Republikën e Maqedonisë së Veriut në masë të marrë përputhen me të dhënat nga baza MAKSTAT. Nevojiten konsultime të përbashkëta të palëve relevante për zbardhjen e evidencës statistikore..

Në tabelën 5 janë paraqitur të dhënat britanike për produktet më të eksportuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut. Produktet janë zgjedhur sipas vlerës në vitin 2019, në të njëjtën kohë duke marrë parasysh edhe trendin e pranisë të produkteve në listën e eksportit gjatë periudhës të analizuar. Janë dhënë të dhënat për eksportin e përgjithshëm të Mbretërisë të Bashkuar sipas numrit tarifor për dhjetë produktet dhe është bërë edhe llogaria për pjesëmarrjen në eksportin e produkteve maqedonase nga kategoria e caktuar tarifore në eksportin e përgjithshëm për atë kategori. Gjatë llogarisë janë përdorur të dhënat INTRACEN³⁰ për Mbretërinë e Bashkuar, duke ndjekur parimin e përdorimit të të dhënave nga një burim për një vend.

²⁸ <http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef>

²⁹ www.trademap.org, është qasur në datë 15.05.2020

³⁰ Shtetet kanë të drejtë të dërgojnë të dhëna të përditësuara apo të rishikuara dhe për këtë arsye mund të vijë deri te ndryshimet. Të dhënat në këtë analizë janë në pajtim me gjendjen e INTRACEN gjatë qasjes në datë 15.5.2020.



TABELA 4.

Eksporti nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Mbretërinë e Bashkuar sipas produkteve
(në mijëra euro dhe përqindje)

Nr.	Shenja tarifore	Emri/përshkrimi	2007	2010	2013	2016	2017	2018	2019
1.	2620999500	Zgjyrë, hi dhe mbetje (përveç nga prodhimi i hekurit apo çelikut)...	0	0	5158	10016	11652	9265	32868
		Pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm të RMV	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2	0.5
		Pjesëmarrje në eksportin e MV në MB	0.0	0.0	8.5	18.4	16.7	9.0	22.9
2.	9401908000	Ulëse (përveç ato nga numri tar. 9402)...	0	0	38	85	9901	23630	18635
		Pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm në RMV	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.4	0.3
		Pjesëmarrje në eksportin e MV në MB	0.0	0.0	0.1	0.2	14.2	23.0	13.0
3.	3815120000	Katalizatorë me bazë, me metal të çmuar apo me bashkëdyzime të metaleve të çmuara si materie aktive	0	10388	3607	6112	4867	11907	17390
		Pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm të RMV	0.0	0.4	0.1	0.2	0.1	0.2	0.3
		Pjesëmarrje në eksportin e MV në MB	0.0	23.3	5.9	0.0	7.0	11.6	12.1
4.	2402209000	Puro, cigarillo dhe cigare, nga duhani apo nga zëvendësimi për duhan: cigare që përmbajnë duhan: tjetër	0	0	0	0	0	2702	8104
		Pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm në RMV	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1
		Pjesëmarrje në eksportin e MV në MB	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	2.6	5.6
5.	2710192100	Kerozin: karburant për motorr reaktiv	202	249	4227	1632	2055	3283	4798
6.	7112990000	Mbeturina dhe skrap nga metalet e çmuara apo nga metalet e platinuara me metale të çmuara: skrap tjetër	0	0	2046	3717	1669	4699	4187
7.	9401610000	Ulëse tjera, me skelet të drurit, të veshura	0	1014	1630	2191	1973	1816	2595
8.	6204631800	Pantallona, pantallona me rripa dhe me mbajtëse, pantallona brixh dhe pantallona të shkurta: për gra apo vajza	6686	2939	2837	454	632	2314	1612
9.	2105001000	Akullore apo akull tjetër për ngrënie, me shtesa apo pa shtesa të kakaos: Pa përmbajtje të yndyrës të qumshut apo me përmbajtje më pak se 3% të peshës të yndyrës të tillë	0	0	0	67	813	1837	881
10.	9404909000	Mbajtës të dyshekëve; sende të shtratit dhe mallrat e ngjashme (për shembull, dyshek, jorgan, pendë, jastëk dhe jastëk të vegjël), me federë apo të mbushur me çfarëdo qoftë materiali ...	0	0	0	0	5996	5480	840

Burimi: Enti shtetëror për statistika – baza MAKSTAT



TABELA 5.

Importi në Mbretërinë e Bashkuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut sipas produkteve
(në mijëra euro dhe përqindje)

Nr.	Shenja tarifore	Emri/përshkrimi	2007	2010	2013	2016	2017	2018	2019
1.	7112990000	Mbeturina dhe skrap nga metale të çmuara apo metal të platinuar me metale të çmuara... (eksport nga MV)	0	571	0	5886	2551	13771	41878
		Pjesëmarrje në importin nga MV në importin e përgjithshëm britanik të 71129900	0.0	0.1	0.0	0.9	0.3	1.5	3.5
2.	9401908000	Ulëse (përveç atyre nga numri tarifor 9402).... (import nga MV)	0	0	20	62	8880	19010	13731
		Pjesëmarrje në importin nga MV në importin e përgjithshëm britanik të 9401908000	0.0	0.0	0.0	0.0	0.8	1.9	1.5
3.	9404909000	Mbajtës të dyshekëve; sende të shtratit dhe mallëra të ngjajshme (për shembull, dyshek, jorgan, pendë, jastëk... (import nga MV)	1496	5100	6603	7421	8725	9501	9173
		Pjesëmarrje në importin nga MV në importin e përgjithshëm britanik të 9404909000	0.6	2.2	2.7	2.5	2.8	3.1	2.9
4.	2402209000	Puro, cigarillosa dhe cigare, nga duhani apo zëvendësime për duhan... (import nga MV)	0	0	0	0	0	2762	8529
		Pjesëmarrje në importin nga MV në importin e përgjithshëm britanik të 2402209000	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.8	2.3
5.	7112990000	Mbetje dhe skrap nga metale të çmuara apo metale të platinuara me metale të çmuara... (import nga MV)	0	0	0	0	0	0	8104
		Pjesëmarrja në importin nga MV në importin e përgjithshëm britanik të 7112990000	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	16.6
6.	7112300000	Hi që përmban metale të çmuara apo bashkëdyzime të metaleve të çmuara (import nga MV)	0	0	0	77	21487	13743	6260
		Pjesëmarrja në importin nga MV në importin e përgjithshëm britanik të 71123000	0.0	0.0	0.0	0.0	3.1	1.8	0.6
7.	2620999500	Zgjyrë, hi dhe mbetje (përveç nga prodhimi i hekurit apo çelikut)... (import nga MV)	0	0	8061	15160	0	0	4373
		Pjesëmarrje në importin nga MV në importin e përgjithshëm britanik të 2620999500	0.0	0.00	0.9	12.6	0.0	0.0	88.2
8.	6202110000	Pelerinë, mantel për shi dhe produkte të ngjajshme për gra dhe vajza... (import nga MV)	1776	668	121	134	384	884	2083
		Pjesëmarrje në importin nga MV në importin e përgjithshëm britanik të 6202110000	1.9	0.7	0.1	0.1	0.4	0.8	2.1
9.	9401690000	Ulëse tjera me skelet druri: tjerë (import nga MV)	21	216	2501	3285	3144	2715	2004
		Pjesëmarrja në importin nga MV në importin e përgjithshëm britanik të 9401690000	0.0	0.2	2.4	2.5	2.3	2.3	1.7
10.	6204631800	Pantallona, pantallona me rripa dhe mbajtëse, pantallona brixh dhe pantallona të shkurta: për gra... (import nga MV)	8173	3904	3259	337	631	2485	1685
		Pjesëmarrje në importin nga MV në eksportin e përgjithshëm britanik të 6204631800	2.1	1.4	1.5	0.1	0.3	0.9	0.7

Burimi: ITC TRADEMAP database



Nga krahasimi i tabelave 4 dhe 5, mund të vërehet se shtatë nga dhjetë produkte paraqiten në të dy palët. Sidoqoftë, është me rëndësi të theksohet se **ka dallime të mëdha edhe në rradhitjen (rëndësinë) e produkteve dhe në vlerat absolute në evidencën e dy palëve**. Sipas tabelës 3, **produktet maqedonase me eksport më të madh në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2019 janë ulëset, katalizatorët, zgjyra, hiri, skrap dhe purot, cigarollosat dhe cigaret**, sipas vlerës absolute dhe pjesëmarrjes në eksportin kah Mbretëria e Bashkuar. **Në palën britanike, sipas të dhënave nga INTRACEN, produkte më të eksportuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut në vitin 2019 janë: Mbetje dhe skrap nga metale të çmuara apo nga metali i platinuar me metale të çmuara (në pozitën 6 në tabelën 4), ulëse (në pozitën 2 në tabelën 4), mbajtëse të dyshekëve (në pozitën 10 në tabelën 4) dhe puro, cigarilloja dhe cigare (në pozitën 4 në tabelën 4).**

Më tutje, një nga produktet më të rëndësishme të evidentuara gjatë eksportit maqedonas në Mbretërinë e Bashkuar – katalizatorët me bazë, me metal të çmuar apo me bashkëdyzim të metaleve të çmuara si materie aktive, është theksuar me një vlerë shumë të vogël absolute të importit të palës britanike dhe nuk është përfshirë në dhjetë produktet e para (17.7 milion euro si eksport nga MV në Mbretërinë e Bashkuar kundrejt 544 mijë euro import britanik nga MV në vitin 2019). Nga ana tjetër, kategoria tarifore zgjyrë, hi dhe skrap që në evidencën maqedonase është produkti i parë eksportues në Mbretërinë e Bashkuar me vlerë më të lartë në vitin 2019, në evidencën britanike është përmendur me vlerë pothuajse 8 herë më të vogël. Megjithatë, analiza tregon se importi britanik përmban produkte tjera nga kategoria e mbetjeve dhe skrapit nga metalet e çmuara, që udhëzon në kategorizim të ndryshëm tarifar të produktit të njëjtë.

Siç është përmendur më herët, kjo situatë në evidenca të ndryshme e vështirëson analizën krahasuese. Në këtë rast, duke patur parasysh se eksporti/importi i produkteve të përmendura është pa doganë dhe kufizime tjera doganore, kjo mospërputhje në evidencë nuk tërheq probleme të mëdha, megjithatë pamundëson që të fitohet një fotografi e qartë për atë se sa produktet e eksportuara maqedonase në Mbretërinë e Bashkuar kanë rëndësi në atë vend. Kjo pasqyrohet sidomos negativisht në kontekst të marrëveshjes të përbashkët të trajtimit tregtar të produkteve të caktuara, nëse për këtë ka nevojë.



2.3 Kompanitë me pjesëmarrje më të madhe në importin/eksportin e Republikës të Maqedonisë së Veriut nga/në Mbretërinë e Bashkuar

Sipas të dhënave nga administrata doganore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si kompani me pjesë më të madhe në tregtinë me Mbretërinë e Bashkuar paraqiten IHD nga industria automobilistike. Në tabelën 6 janë treguar kompanitë me import/eksport më të madh nga/në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2018.³¹ Të dhënat janë marrë nga administrata doganore e Republikës të Maqedonisë së Veriut. Ata tregojnë se **11 nga gjithsej 15 kompani në anën e importit, si dhe 5 nga 15 kompani në anën e eksportit janë firma me seli në zonat e lira për eksport teknologjik, kryesisht të themeluar me kapital të huaj.**³² Kjo tregon se importi nga Mbretëria e Bashkuar pothuajse se në tërësi është përcaktuar nga IHD, që thekson rëndësinë e trajtimit të IHD në vend, duke përfshirë edhe kushtet e tregtisë të jashtme.

TABELA 6.

Kompanitë me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut me import/eksport më të lartë nga/në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2018

	Import	Eksport	
1.	XHONSON METI, Shkup	XHONSON METI, Shkup	
2.	TAB MAK SHPK Probishtip	LEAR KORPOREJSHËN MAQEDONI, Tetovë	
3.	ADIENT SEATING SHPKNJP, Shtip	ADIENT AUTOMOTIV, Strumicë	
4.	LEAR KORPOREJSHËN MAQEDONI, Tetovë	MAKPETROL SHA SHKUP	
5.	AUTOMOBILI GRUP, eksport-import Shkup	Imperial Tobako TKS sh.a.	
6.	ADIENT AUTOMOTIV, Strumicë	DIK FAGUS, Pehçevë	
7.	KOLA SHPKNJP Shkup	KOMFI-ANGEL SHPK Prilep	
8.	GENTERM MAQEDONI, Prilep	Shoqata e përzier CERMAT SHPK Manastir	
9.	BRAKO	INNCO MAK SHPK Lagovë e re Prilep	
10.	VAN HOLL MAQEDONI, Ilinden	KOSTAL MAQEDONI, Ohër	
11.	GLOBAL MOTORS, Shkup	TAB MAK SHPK Probishtip	
12.	KOSTAL MAQEDONI, Ohër	HAJ-TEK KORPORATA SHPK f.Oreshan	
13.	XHONSON SEJFTI SISTEMS, Kërçovë	SHTSH LIBRI AKADEMIK, eksport-import Shkup	
14.	KROMBERT DHE SHUBERT MAQEDONI, Manastir	BRAKO	
15.	KEMET ELEKTRONIKS MAQEDONI, Shkup	EURONIKEL SHPKNJP Shkup	

Burimi: Administrata doganore e Republikës të Maqedonisë së Veriut

³¹ Gjatë punimit të studimit, kanë qënë të disponueshme të dhënat për vitin 2018.

³² Haj – tek korporata është kompani maqedonase me investim në zonën e lirë Shkup 1.



Nga tabela 6 mund të vërehet se gjashtë kompani paraqiten edhe në anën e importit edhe në anën e eksportit. Kjo tregon varësi të eksportit nga importi i lëndëve të para dhe repromateriale tjera të cilat përdoren në procesin e prodhimit të paraparë për eksport, si dhe plasman të një pjesë të eksportit në Mbretërinë e Bashkuar. Siç është sqaruar më lartë (pika 1), pjesë e madhe nga eksporti i IHD plasohet në Gjermani, që tërheq deficit të lartë të Republikës të Maqedonisë të Veriut në tregtinë me Mbretërinë e Bashkuar që ishte rreth 620 milion euro në vitin 2017 dhe 2018, kurse është thelluar në 835 milion euro në vitin 2019.

TABELA 7.

Kompanitë me importin më të lartë nga Mbretëria e Bashkuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2018 (në mijëra euro dhe përqindje)

	Kompania	Shenja tarifore	Emri/përshkrimi	Eksporti	Pjesëmarrja në importin e përgjithshëm nga MB	Pjesëmarrja në importin e përgjithshëm të MQ
1.	XHONSON METI, Shkup	71101100000	Platinum – I papërpunuar apo në pluhur	395662	54.2	9.20
		71102100000	Paladium: I papërpunuar apo në pluhur	218652	30.0	5.09
		28439090000	Uranium, natyral dhe bashkëdyzimet e tij; legura	36969	5.1	0.86
		Tjetër		3775	0.5	0.08
2.	TAB MAK SHPK Probishtip	78041900000	Pllaka, fletë metalike, shirita dhe foli: Tjetër	5892	0.8	0.13
		Tjetër		25	0.0	0.0
3.	ADIENT SEATING SHPKNJ Shtip	59031090000	Pluhura tekstili, të ngopura, të lyera....	2758	0.4	0.06
		59032090000	Pluhura tekstili, të ngopura, të lyera...me poliuretan	1715	0.2	0.04
		Tjetër		1304	0.2	0.03
4.	LEAR KORPOREJSHËN Tetovë	59032090000	Pluhura tekstili, të ngopura, të lyera...me poliuretan	2980	0.4	0.07
		Tjetër		890	0.1	0.02
5.	AUTOMOBIL GRUP, Shkup	87033219100	Automjete tjera me motor me klipa me djegje të brendshme	1037	0.1	0.02
		87033319100	Automjete tjera, dizel dhe gjysëm dizel...	955	0.1	0.01
		Tjetër		579	0.1	0.01

Burimi: Administrata doganore e Republikës të Maqedonisë së Veriut



Të dhënat e hollësishme për importin/eksportin të MV nga/në Mbretëria e Bashkuar sipas kompanive janë dhënë në tabelat 7 dhe 8. Tabelat përmbajnë të dhëna për pesë kompanitë me pjesëmarrje më të lartë në shkëmbimin tregtar maqedonas me Mbretërinë e Bashkuar.

Në tabelën 7 janë paraqitur kompanitë që më së shumti eksportojnë nga Mbretëria e Bashkuar. Siç mund të vërehet nga të dhënat, **kompania “Xhonson Meti” merr pjesë me pothuajse 90% në importin e MV nga Mbretëria e Bashkuar dhe me mbi 15% në importin e përgjithshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2018.** Këto të dhëna tregojnë varësi jashtëzakonisht të lartë të importit të MV nga kjo kompani. Analiza e paraqitur më lartë në lidhje me shkëmbimin tregtar ndërmjet dy vendeve sipas produkteve ka theksuar varësinë e lartë të tregtisë nga tre produktet (platinium, paladium dhe uranium), kurse analiza sipas kompanive tregon një varësi të lartë nga një kompani që eksporton këto tre produkte. Ky kombinim thekson se **eksporti nga Mbretëria e Bashkuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut kryesisht është përcaktuar nga aktivitetet të vetëm një kompanie.**

Në tabelën 8 janë paraqitur pesë kompanitë me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut (në pronësi shtetërore dhe vendore) të cilat kanë eksport më të madh në Mbretërinë e Bashkuar. Është evidente se **“Xhonson Meti” është kompani me eksport më të madh kumulativ nga Republika e Maqedonisë së Veriut ndaj Mbretërisë të Bashkuar, kurse “Lear Korporejshën” është kompania me vlerë më të lartë të eksportit sipas numrit tarifar.** Kjo kompani eksporton ulëse për automobila dhe ka pjesë prej 18.7% në eksportin e tërësishëm të MV ndaj Mbretërisë të Bashkuar në vitin 2018.

“Xhonson Meti” ka katër produkte kryesore eksportuese dhe disa dytësore, me pjesëmarrjen e tyre të përgjithshme të kumuluar prej 30.7% në eksportin e tërësishëm të MV drejtë Mbretërisë të Bashkuar në vitin 2018. Duke e analizuar në kontekst të pjesëmarrjes në eksportin e tërësishëm nga Republika e Maqedonisë së Veriut, pjesëmarrja në këto kompani është e vogël, kurse arsyeja për eksportin më të ulët drejtë Mbretërisë të Bashkuar në lidhje me eksportin nga ky vend është diskutuar më lartë. Në fakt, **pjesë e madhe e produkteve që prodhohen në “Xhonson Meti” dhe IHD të tjera në Republikën e Maqedonisë së Veriut eksportohen në Gjermani, dhe jo në vendet amë të kompanive.** Në Gjermani ka të ashtq “hab” të industrisë automobilistike dhe qendrave shpërndarëse të më shumë prodhuesve botërorë nga kjo degë, që tërheq dallimet ndërmjet fotografisë të eksportit dhe të importit në Republikën e Maqedonisë së Veriut me Mbretërinë e Bashkuar.

Sidoqoftë, duhet të merret parasysh se ekziston ndërlidhje të eksportit dhe importit sepse importi kryhet për shkak të eksportit, respektivisht eksportohen lëndë të para dhe inpute tjera të nevojshme për prodhimin e produkteve të gatshme të cilat pastaj eksportohen. Në këtë konteskt, shkëmbimi tregtar me Mbretërinë e Bashkuar duhet të shqyrtohet edhe nga aspekti i prejardhjes të mallrave që është tepër e rëndësishme duke patur parasysh se inputet kryesisht importohen nga një vend (Mbretëria e Bashkuar), kurse produktet e gatshme eksportohen në vend tjetër (Gjermani). Me qëllim që të sigurohet një kqyrje më e hollësishme në ndërlidhjen e importit me eksportin, janë analizuar 10 produktet më të rëndësishme të cilat nga Republika e Maqedonisë së Veriut eksportohen në Gjermani, si destinacion për eksport të produkteve të prodhuara me inpute nga Mbretëria e Bashkuar.



TABELA 8.

Kompanitë me eksport më të lartë nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2018 (në mijëra euro dhe përqindje)

	Kompania	Shenja tarifore	Emri/përshkrimi	Eksporti	Pjesëmarrja në eksportin e MV ndaj MB	Pjesëmarrja në eksportin e përgjithshëm të MV
1.	XHONSON METI SHPKNJ Shkup	38151200000	Katalizatorë me bazë, me metal të çmuar apo me bashkëdyzim të metaleve të çmuara si materie aktive	11902	11.6	0.20
		26209995000	Zgjyrë, hi dhe skrap (përveç nga prodhimet e hekurit ...)	9268	9.0	0.16
		84213935000	Makineri dhe aparate për filtrimin apo pastrimin e gazrave... me procedure të lëngët	5480	5.3	0.09
		71129900000	Mbeturina dhe skrap nga metale të çmuara apo nga metali i platinuar me metale të çmuara; mbetje tjera...	4699	4.6	0.08
		Tjetër		231	0.2	0.00
2.	LEAR KORPOREJSHËN SHPKNJ Tetovë	94019080000	Ulëse (përveç ato nga nr tarifor 9402)...	19173	18.7	0.32
3.	ADIANT AUTOMOTIVE Strumicë	94019080000	Ulëse (përveç ato nga numri tar. 9402)...	3933	3.8	0.07
4.	MAKPETROL SHA SHKUP	27101921000	Kerozin: karburant për motor reaktiv	3265	3.2	0.06
5.	Imperial tobako TKS sh.a	24022090000	Puro, cigarillosa dhe cigare, nga duhani apo nga zëvendësimet e duhanit	2702	2.6	0.05

Burimi: Administrata doganore e Republikës të Maqedonisë së Veriut



TABELA 9.

Dhjetë produktet më të eksportuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Gjermani në vitin 2018 (në mijëra euro dhe përqindje)

	Shenja tarifore	Emri/përshkrimi	Eksporti MV në Gjermani	Pjesëmarrje në eksportin e përgj. sipas tarifës	Pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm të MV
1.	3815120000	Katalizator me bazë, me metal të çmuar apo me bashkëdyzime të metaleve të çmuara si materie aktive	997885	99.1	17.0
2.	8421393500	Makineri dhe aparate për filtrimin dhe pastrimin e gazrave: Makineri dhe aparate për filtrimin apo pastrimin e gazrave tjea: Me procedure të lëngët	609567	99.3	10.4
3.	8544300000	Komplete të përcuesve për ndezje dhe komplete tjera të përcuesve për autormjete, aeroplan ose anije	248336	51.8	4.2
4.	3815909000	Iniciatorë në reaksion, përshpejtues të reaksionit dhe preparate katalitike, që nuk janë përmendur apo përfshirë në vend tjetër	218521	99.9	3.7
5.	8537109800	Tabela, pllaka, pulte, tavolina, dollap dhe baza tjera, të pajisura me dy apo më shumë aparate nga numri tar 535 apo 8536, për menaxhimin elektrik apo shpërndarjen e energjisë elektrike, për tension jo më të madh se 1000 V: Tjetër	129098	93.6	2.2
6.	9401908000	Ulëse (përveç atyre me numër tar 9402), duke përfshirë edhe ata që mund të shndërrohen në shtretër, dhe pjesë të tyre: Pjesë: tjetër	83922	46.5	1.4
7.	6205200000	Këmisha për burra ose djem: nga pambuku	44965	72.5	0.8
8.	6206400000	Bluza, këmisha dhe këmisha – bluza, për gra apo vajza: Nga fibrat artificial apo sintetikë	23798	77.7	0.4
9.	6206300000	Bluza, këmisha dhe këmisha – bluza, për gra apo vajza: nga pambuku	17205	78.5	0.3
10.	8512301000	Pajisje për sinjalizim me zë: Aparate alarmi për mbrojtjen nga vjedhjet, të destinuara për automjetet motorike	17234	100	0.3

Burimi: Enti shtetëror për statistike – baza MAKSTAT




Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 9, është evidente se **dhjetë produktet më të rëndësishme eksportuese nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Gjermani janë të lidhura me tre industri – automobilistike, prodhimtari të makinerive dhe aparateve dhe industrinë e tekstitit.** Në të njëjtën kohë, produktet e klasifikuara si makineri dhe aparate janë pjesë të industrisë automobilistike. Dhjetë produktet më të eksportuara në Gjermani marrin pjesë me 40.7% në eksportin e tërësishëm të Republikës të Maqedonisë së Veriut në vitin 2018, me atë që 37.5% bëjnë pjesë në pesë produktet e para. Kjo tregon një përqendrim jashtëzakonisht të lartë të eksportit drejt Gjermanisë, që korrespondon me përqendrim të lartë të eksportit në disa produkte. **Produkti kryesor i eksportit – katalizatorët me bazë nga metali i çmuar, është drejtëpërdrejtë i lidhur me importin nga Mbretëria e Bashkuar të platiniumit, paladiumit, dhe uraniumit (legurat).** Eksporti i katalizatorëve në Gjermani kryhet nga “Xhonson Meti” respektivisht përmes këtij produkti pasqyrohet raporti import nga Mbretëria e Bashkuar – prodhim në Republikën e Maqedonisë së Veriut – eksport në Gjermani. E njëjta i referohet edhe produktit të dytë – makineri dhe aparate për pastrimin dhe filtrimin e gazrave. Këto dy produkte janë më të rëndësishme edhe në eksportin e “Xhonson Meti” ndaj Mbretërisë të Bashkuar (tabela 8), me atë që sasi të vogla të produkteve importohen atje, kurse pjesa më e madhe plasohen në Gjermani. Në mënyrë të ngjajshme bëhet importi – prodhimi – eksporti edhe i katër produkteve tjera të paraqitura në tabelën 9 (pozita 2 deri në pozitën 6), me atë që eksporti i uleseve bëhet nga “Lear Korporejshën” dhe “Adient seating” të cilat importojnë materiale nga Mbretëria e Bashkuar (tabela 7).

Kjo rrjedhë e tregtisë, me çrast importi i lëndëve të para është nga një vend (Mbretëria e Bashkuar), prodhimi i produkteve të gatshme kryhet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kurse eksporti në vend të tretë (Gjermani), udhëzon në çështjen për nevojën e përdorimit të instrumentit të prejardhjes të mallrave. Kjo çështje është rregulluar hollësisht në marrëdhëniet e Republikës të Maqedonisë së Veriut me BE, në atë mënyrë që të dy palët janë anëtare të PEM Konventës për prejardhjen e mallrave,³³ që siguron zbatimin e kumulimit diagonal të prejardhjes të mallrave ndërmjet BE, EFTA, Turqisë dhe Ishujve Faroe. Kjo nënkupton se tregtia e përshtatshme më lartë kryhet pa problem, respektivisht prodhimet që eksportohen në Gjermani, kurse përpunohen në Republikën e Maqedonisë së Veriut me lëndë të para dhe komponenta nga Mbretëria e Bashkuar, mund të eksportohen në Gjermani, me përdorimin e instrumentit të kumulimit diagonal të mallrave, nëse për të njëjtin ka nevojë.

Në lidhje me eksportimin e produkteve kryesore nga industria automobilistike, analiza ka treguar se produktet e gatshme kryesisht eksportohen nën numrë të ri tarifor, dhe jo me zbatimin e rregullës të vlefshme që është thelbësore gjatë kumulimit të prejardhjes. Kjo do të thotë se **pas bregzit, prejardhja e mallrave për produktet aktuale më të eksportuara nuk do të jetë problem i rëndësishëm për tregtinë që përfshin lëndët e para britanike.** Sidoqoftë, kjo çështje mund të bëhet më vonë e rëndësishme në kontekst të tregtisë të jashtme ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar, e për këtë shkak duhet të inkorporohet në platformën për bashkëpunim tregtar pas bregzit ndërmjet dy palëve.

³³ https://ec.europa.eu/taxation_customs/business/calculation-customs-duties/rules-origin/general-aspects-preferential-origin/arrangements-list/paneuromediterranean-cumulation-pem-convention_en





3.

Platforma pas bregzit për marrëdhëniet tregtare ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar

Paralelisht me aktivitetet e lidhura me Bregzit në gjysmën e dytë të vitit 2019, Mbretëria e Bashkuar ka inicuar aktivitete për rregullimin e marrëdhënieve tregtare me vendet të cilat nuk janë anëtare të BE, megjithatë kanë marrëveshje tregtare preferenciale me Bashkimin European. I tillë është rasti me Republikën e Maqedonisë së Veriut, marrëdhëniet tregtare të së cilës me BE janë të rregulluara me MSA. Rezultati nga negociatat ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar është Marrëveshja për partneritet, tregti dhe bashkëpunim ndërmjet dy palëve.

Në vazhdim është bërë analizë e dy dokumenteve – Marrëveshja për stabilizim dhe asocim (MSA) e lidhur ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe BE dhe Marrëveshja për partneritet, tregti dhe bashkëpunim të Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar (MPTB) me qëllim që të identifikohen çështjet më të rëndësishme të platformës tregtare pas bregzit për Republikën e Maqedonisë së Veriut.

MPTB në tërësi e ndjek MSA në aspekt të strukturës dhe zgjidhjeve të cilat janë inkorporuar në marrëveshjen ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe BE. Kjo lehtëson shumë bashkëpunimin e mëtutjeshëm tregtar ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar sepse pjesa më e madhe e çështjeve të bashkëpunimit të ndërsjellë janë bazuar në zgjidhje tashmë të definuara. Sidoqoftë, ekzistojnë disa çështje të cilat duhet të shqyrtohen që të përcaktohet nëse është siguruar zgjidhja më e mirë e mundshme për palën maqedonase. Ata i referohen kësaj në vijim:

1. Neni 1, paragrafi 3 i MPBT parasheh se të dy palët (Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Mbretëria e Bashkuar) do të themelojnë zonën e tregtisë të lirë për mallra. Kjo do të thotë njohjen e progresit të arritur me MSA dhe ndërtimin e marrëdhënieve të mëtutjeshme përmes avancimit të bashkëpunimit tregtar. Në pajtim me shkëmbimin tregtar ndërmjet dy palëve të paraqitur në pikën 2 nga ky punim, **kjo zgjidhje është shumë e përshtatshme dhe do të sigurojë stabilitet në kushtet e tregtisë.** Duke patur parasysh se Mbretëria e Bashkuar është jashtëzakonisht e rëndësishme në anën e eksportit për Republikën e Maqedonisë së Veriut (Tabela 2), duhet të parandalohet çdo prishje apo vonesë në marrëdhëniet tregtare sepse kjo shumë fuqimisht do të pasqyrohej mbi tregtinë e MV. Në të njëjtën kohë, deklarata politike ndërmjet Mbretërisë të Bashkuar dhe BE, e nënshkruar në 19 tetor të vitit 2019, udhëzon



se edhe marrëdhëniet e tyre tregtare ndërkombëtare do të ndërtohen mbi bazë të Marrëveshjes për tregti të lirë. Rrjedhimisht, është e përshtatshme vendosja e MSA si bazë gjatë dakordimit të marrëdhënieve bilaterale ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar.

2. Neni 3 nga MPBT i referohet hyrjes në fuqi të dispozitave nga marrëveshja. Kjo do të varet nga periudha kur do të ndodh dalja faktike e Mbretërisë të Bashkuar nga tregu i përbashkët i Bashkimit Europian, që është diskutuar më detajisht në pikën 1 nga kjo analizë. Pavarësisht se kur tërësisht do të realizohet hapi i fundit nga Bregziti, është me rëndësi që të mos kemi periudhë të mosrregullimit të marrëdhënieve tregtare ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar.

Nëse Mbretëria e Bashkuar dhe BE nuk lidhin marrëveshje për tregti të lirë deri në fund të vitit 2020, apo nuk e vazhdojnë periudhën tranzitore (kjo duhet të dakordohet deri në korrik 2020), atëherë këto dy palë do të duhet të zbatojnë rregullat e OBT në shkëmbimin e ndërsjellë. Kjo situatë mund të pasqyrohet në ndryshimin e rrjedhave tregtare ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar, respektivisht eksporti i MV nga IHD që në mënyrë vijuese kryhet në Gjermani (grafiku 2 dhe tabela 9), mundet eventualisht të devijohen ndaj Mbretërisë të Bashkuar apo vendit tjetër. Në aspekt të devijimit, aspekti më i rëndësishëm që duhet të merret parasysh është prejardhja e mallrave, megjithatë, siç është analizuar më lartë, ai instrument nuk përdoret shumë në tregtinë ekzistuese, që e amortizon çështjen e devijimit të tregtisë vijuese për shkak të prejardhjes të mallrave.

Përpjekjet që i bën Mbretëria e Bashkuar për lidhjen e marrëveshjeve nga lloji i MPBT para daljes faktike nga tregu i përbashkët të BE kanë për qëllim që të sigurohet një kalim sa më pak i dhimbshëm në situatën e re për kompanitë britanike. Sipas analizës, varësia e lartë e tregtisë të MV nga Mbretëria e Bashkuar (të drejtëpërdrejtë apo tërthorë) kërkon rregullim të qartë dhe në kohë të marrëdhënieve të ndërsjella, megjithatë **në MPBT duhet të sigurohet respektimi i zgjidhjeve ndërmjet BE dhe Mbretërisë të Bashkuar, duke patur parasysh MSA. Në këtë kontekst, është thelbësore zbatimi i MPBT pas përfundimit të periudhës tranzitore për zgjidhjen e çështjeve tregtare ndërmjet Mbretërisë të Bashkuar dhe BE të cilat dalin nga Bregziti.** Kjo periudhë në mënyrë vijuese është përcaktuar që të përfundojë në 31 dhjetor të vitit 2020. Deri atëherë Mbretëria e Bashkuar faktikisht do të jetë pjesë e tregut të brendshëm të BE, që nënkupton se do të vlejë MSA në lidhje me marrëdhëniet tregtare ndërmjet palëve të MV dhe asaj britanike. **Nëse ka vazhdim të periudhës tranzitore, atëherë zbatimi i MPBT do të shtyhet në pajtim me marrëveshjen ndërmjet BE dhe Mbretërisë të Bashkuar. Derisa Mbretëria e Bashkuar faktikisht është pjesë e tregut të BE, mbetet të zbatohet MSA në marrëveshjet tregtare të maqedonase – britanike.**

3. Neni 8 nga MPBT i referohet kuotave doganore të përkufizuara në nenin 27 (2) nga MSA, Aneksi IV (b), Aneksi IV(c), Aneksi V (c), dhe Aneksi III nga Protokollu III, me propozim që Mbretëria e



Bashkuar të marrë 13.62% me kuota përkatëse për të gjithë produktet bujqësore dhe udhqimore që Republikës të Maqedonisë së Veriut që janë dhënë sipas MSA. Kjo llogari është bërë nga pala britanike, sipas gjetjeve të tyre se sa pjesë e kuotave të tashme me BE duhet t'i takojnë Mbretërisë të Bashkuar. Duke patur parasysh se tregtia maqedonase – britanike me produkte të cilat janë rregulluar me kuota është tepër e vogël, **kuotat e propozuara nga ana e Mbretërisë të Bashkuar janë të favorshme sepse japin hapësirë për intensifikim të rëndësishëm të tregtisë ndërmjet dy palëve, e cila duhet të nxitet me masa përkatëse tregtare.**

4. Ndryshimet në MPBT në lidhje me Protokollin I (tekstil dhe veshje) dhe Protokollin II (produktet e çelikut) i referohen mosveprimet të anëtarëve të MSA të cilat e rregullojnë regjimin asimetrik ndërmjet BE dhe Republikës të Maqedonisë. **Kjo zgjidhje është më e përshtatshme për marrëveshjet tregtare pa tbregzit ndërmjet dy palëve.** Duke patur parasysh se regjimi asimetrik me BE përfundoi në vitin 2011 për produktet e tekstilit kurse në vitin 2006 për produktet e çelikut, **nuk do të ishte e dobishme që të diskutohet për vendosjen e sërishme të regjimit të mbrojtur (simetrik apo josimetrik) i cili gjithsesi do të kishte tendencë që të anulohet pas periudhës të caktuar kohore në frymën e përcaktimit për tregti liberale ndërmjet dy palëve.** Krahas kësaj, produktet tekstile dhe rrobat respektivisht veshjet janë produkte tradicionale me të cilat tregtojnë dy palë, ashtuqë situata një herë e arritur e tregtisë pa dogana nuk duhet të kthehet. Nga ana tjetër, sektori “Hekur dhe çelik” është një nga sektorët më të fuqishëm eksportues të Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe duhet të kërkohen mënyra për ngritjen e eksportit nga ky sektor në tregun britanik, pa kufizime tregtare.

5. Për protokollin IV, i cili i referohet përkufizimit të konceptit të prejardhjes të mallrave dhe metodave të bashkëpunimit administrativ, është zhvendosur tekst i ri MPBT. Sipas strukturës dhe rregullave të shkruara, ai është i ngjajshëm me Protokollin IV nga MSA, kurse dallimi kryesor është se është braktisur paragrafi n nga neni 1 i cili parasheh se Protokollin IV nga MSA bazohet në Konvenën Rajonale të rregullave preferenciale pan-euro-mesdhetare të prejardhjes.³⁴ Përkufizimi i rregullave dhe qasjes territoriale në lidhje me prejardhjen e mallrave është bërë nga perspektiva e dy palëve, me atë që **Zvicra, Lihtenshtajni, Islanda, Norvegjia (EFTA shtetet), Turqia dhe Bashkimi European janë përfshirë në kumulimin e prejardhjes dhe në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut (neni 3 dhe neni 4) nga Protokollin IV në MPBT.** Kjo nënkupton përdorimin e përfitimeve nga regjimi i deritashëm të kumulimit të prejardhjes (të përkufizuar me MSA) në tregtinë e ndërsjellë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ndryshimet tjera në Protokollin IV në MPBT, krahasuar me Protokollin IV në MSA janë përkufizuar qartë në pajtim me rregullat e Konventës ekzistuese PEM.

6. Çështja e prejardhjes të mallrave është një çështje kryesore në lidhje me marrëdhëniet tregtare ndërmjet të dy palëve e cila drejtpërdrejtë do të pasqyrohet në eksportin maqedonas,

³⁴ https://ec.europa.eu/taxation_customs/business/calculation-customs-duties/rules-origin/general-aspects-preferential-origin/arrangements-list/paneuromediterranean-cumulation-pem-convention_en



sidomos nga IHD, duke patur parasysh varësinë e importit të prodhimtarisë në këto kompani. Në të njëjtën kohë, duhet të merret parasysh se aktualisht eksporti po kryhet kryesisht drejtë Gjermanisë, megjithatë, në varësi nga marrëdhëniet e ardhshme tregtare ndërmjet Mbretërisë të Bashkuar dhe BE, eventualisht mund të vijë deri te ndryshimi i rrjedhave tregtare, siç është diskutuar më sipër. Në analizë është theksuar se gjatë tregtisë ekzistuese të produkteve që eksportohen nga Republika e Maqedonisë së Veriut, kurse janë prodhuar me lëndë të para dhe komponenta të importuara nga Mbretëria e Bashkuar, **nuk përdoret në mënyrë domethënëse instrumenti i kumulimit diagonal i prejardhjes të mallrave**, që deri diku e amortizon këtë çështje, megjithatë sërish **duhet të sigurohet një zgjidhje e mirë sistemore**. Në këtë drejtim, **shtrirja e përkufizuar territoriale dhe rregullat e akumulimit të prejardhjes të mallrave nga dy palët kontraktuese, EU, EFTA dhe Turqia mund të vlerësohen si pozitive në kontekst të mbajtjes të kushteve ekzistuese të tregtisë**.

Pyetja kryesore në kontekst të prejardhjes të mallrave është statusi i Mbretërisë të Bashkuar në lidhje me Konventën e PEM për kumulimin e prejardhjes të mallrave, në të cilën është bazuar modeli i tashëm i tregtisë me BE dhe si vazhdimësi, me Mbretërinë e Bashkuar. Me realizimin e Bregzit, Mbretëria e Bashkuar nuk e mban automatikisht statusin e anëtares në Konventën PEM, respektivisht do të duhet që të qaset sërish ndaj kësaj marrëveshje, që ende nuk është përkufizuar si qëndrim zyrtar i palës britanike. Në këtë kontekst, **zgjidhja e kumulimit të prejardhjes ndërmjet të dy palëve (Mbretëria e Bashkuar dhe Republika e Maqedonisë së Veriut) aktualisht është e mundur përmes MPBT**. Duke patur parasysh procesin aktual të ndryshimit të Konventës, do të nevojitet që të sigurohet koherencë e MPBT me Konventën. Ata do të ishin aktivitete për avancimin e MPBT në të ardhmen.

E përmbledhur, MPBT është përkufizuar në frymën e vazhdimit të bashkëpunimit tregtar ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar mbi parimet e tregtisë të lirë dhe minimizimit të kufizimeve tregtare. MPBT ofron mundësi për nxitjen e shkëmbimit tregtar përmes konkurrencës, dhe jo përmes mekanizmave mbrojtës. Vlerësimi është se paraqet një platformë solide për bashkëpunim tregtar ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar, kurse përdorimi i saj kërkon përpjekje të përbashkëta nga institucionet relevante dhe bashkësia afariste.



Përfundim

Bregzit ka ndodhur në 31 janar të vitit 2020. Atëherë Mbretëria e Bashkuar formalisht ka ndërprerë anëtarësinë në Bashkimin Europian, megjithatë dalja nga tregu i përbashkët është paraparë që të jetë një periudhë tranzitore prej 11 muajsh. Gjatë periudhës tranzitore duhet të rregullohet marrëdhëniet tregtare dhe marrëdhëniet tjera ndërmjet të dy palëve. Faktikisht, deri në 1 janar të vitit 2021, Mbretëria e Bashkuar do të mbesë pjesë e tregut të vetëm europian dhe do të respektojë rregullat e BE, kurse do të kryejë edhe pagesat në buxhetin e BE. Ekziston mundësia për vazhdimin e periudhës tranzitore për 12 apo 24 muaj, e cila duhet të dakordohet deri në 1 korrik të vitit 2020, nëse të dy palët vendosin për një gjë të tillë. Në kontekst të daljes nga BE, Mbretëria e Bashkuar duhet të rregullojë edhe marrëdhëniet me vendet e treta të cilat kanë marrëveshje tregtare me Bashkimin Europian. Pas periudhës tranzitore, gjatë shkëmbimit tregtar të Mbretërisë të Bashkuar me këto vende do të pushojnë së vleri dispozitat nga marrëveshjet e tyre preferenciale me BE.

Marrëdhëniet tregtare ndërmjet Mbretërisë të Bashkuar dhe Republikës të Maqedonisë së Veriut janë në mënyrë vijuese të rregulluara me Marrëveshjen për stabilizim dhe asocim ndërmjet BE dhe Republikës të Maqedonisë së Veriut. Kjo do të thotë pjesa më e madhe nga tregtia po realizohet pa dogana, kurse mbrojtja në formë të kuotave zbatohet për produktet e caktuara. Në vitin 2018, të dy palët u qasën negociatave për lidhjen e Marrëveshjes për partneritet, tregti dhe bashkëpunim ndërmjet Mbretërisë të Bashkuar dhe Republikës të Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të parandalohet situata e marrëdhënieve jo të rregulluara gjatë daljes faktike të Mbretërisë të Bashkuar nga Bashkimi Europian. Marrëveshja është harmonizuar dhe vendos platformën pas bregzit për bashkëpunim tregtar ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar.

Analiza e shkëmbimit tregtar tregon se Mbretëria e Bashkuar është partneri kryesor tregtar i Republikës të Maqedonisë së Veriut, sidomos në anën e importit. Pjesëmarrja e Mbretërisë të Bashkuar ka qënë 11.5% në importin e përgjithshëm të MV dhe 18.4% në importin nga BE në vitin 2019. Me këtë pjesë, Mbretëria e Bashkuar e ka marrë vendin e parë në listën e importit, respektivisht pjesa më e madhe nga importi i MV është bërë nga ky vend. Sipas strukturës të importit të produkteve, Mbretëria e Bashkuar ka qënë partneri më i rëndësishëm për shkak të importit të tre produkteve britanike – platiniumi, paladiumi dhe uranumi (legura) dominojnë me pjesëmarrje prej 8.6% dhe 10.4% në importin e përgjithshëm të MV në vitin 2018 dhe 2019, respektivisht. Këto tre produkte kanë marrë pjesë me rreth 90% në eksportin e MV nga Mbretëria e Bashkuar në vitin 2018 dhe 2019, që udhëzon në një përqendrim shumë të lartë dhe varësi nga këto tre produkte.

Që të fitohet një fotografi e qartë e tregtisë ndërmjet dy palëve, është analizuar rëndësia e shkëmbimit të ndërsjellë tregtar edhe për palën britanike. Tre produktet kryesore në shkëmbim – platiniumi, paladiumi dhe uranumi (legura) kanë pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm britanik prej 0.7 deri në 0.9% në vjet. Kjo është një pjesëmarrje e vogël, megjithatë duhet të kihet parasysh se tregtia britanike është shumë e lartë sipas vëllimit dhe përbëhet nga shumë produkte. Megjithatë, pjesa e eksportit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në eksportin e përgjithshëm britanik për secilën prej kategorive të theksuara tarifore tregon një pjesëmarrje të lartë e cila te platina ka qënë 51.7% në vitin 2018, kurse te paladiumi dhe uranumi (legura) ka qënë 19.6% dhe 10.2%. Numrat përkatëse kanë qënë 41.1%, 39% dhe 10.6% në vitin 2019. Kjo udhëzon në atë se Republika e Maqedonisë së Veriut



është mjaftë e rëndësishme për palën britanike në lidhje me eksportin e produkteve të përmendura. Kjo nënkupton se ky eksport nga Mbretëria e Bashkuar është lidhur me IHD britanike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kurse kjo lidhje e investimeve dhe tregtisë zakonisht tërheq një interes më të madh të vendi që investon për sigurimin e kushteve të pandërprera (dhe sa më të mira që është e mundur) për tregtinë e firmave të tyre, se sa kur do të bëhej fjalë për tregtinë që nuk është e lidhur me IHD.

Gjatë kontrollit të kryqëzuar të të dhënave për shkëmbimin tregtar të të dy palëve është përcaktuar se lista e produkteve më të eksportuara nga Mbretëria e Bashkuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk përputhet tërësisht me listën e produkteve më të eksportuara nga Mbretëria e Bashkuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu, ekzistojnë dallime edhe në vlerat absolute, respektivisht vlera e tregtisë sipas produkteve. Në këtë drejtim, nevojitet një aktivitet i përbashkët i institucioneve relevante nga të dy palët për zbardhjen e dallimeve statistikore sepse të dhënat janë thelbësore për ndërtimin e politikës të qëndrueshme tregtare.

Nga ana e eksportit, Mbretëria e Bashkuar ka marrë pjesë me 2.2% në eksportin e përgjithshëm të MV dhe 2.8 në eksportin e MV në BE në vitin 2019. Me këtë pjesë, Mbretëria e Bashkuar është në vendin e 11 të destinacioneve eksportuese të MV. Katër produkte – ulëse, katalizatorë, zgjyrë, hi dhe skrap dhe puro, cigarillosa de cigare kanë kushtuar rreth 42% dhe 53.6% nga eksporti i MV në Mbretërinë e Bashkuar në vitet 2018 dhe 2019, respektivisht. Në anën e eksportit nuk shihet një lidhje e drejtëpërdrejtë me Mbretërinë e Bashkuar sepse pjesa më e madhe nga eksporti të IHD të cilat importojnë lëndë të para britanike shkon në Gjermani. Megjithatë, analiza më e detajuar e produkteve më të eksportuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Gjermani ka treguar një lidhje të qartë të produkteve kryesore eksportuese me lëndët e para dhe komponentat e importuara nga Mbretëria e Bashkuar. Produktet e kompanive të cilat kryejnë importin më të madh nga Mbretëria e Bashkuar përbëhet nga eksporti kryesor drejtë Gjermanisë.

Më tutje, analiza ka treguar një përqëndrim shumë të lartë të shkëmbimit tregtar maqedonas-britanik edhe në nivel të kompanive. Pjesa më e madhe nga tregtia e Republikës të Maqedonisë së Veriut me Mbretërinë e Bashkuar kryhet nga ana e IHD. Në fakt, 11 nga 15 kompani të cilat kanë importuar më shumti nga Mbretëria e Bashkuar, si dhe 5 nga 15 kompani të cilat më së shumti kanë eksportuar në atë destinacion janë firma me seli në zonat e lira teknologjike – eksportuese, kryesisht të themeluara me kapital të huaj. Në të njëjtën kohë kompania “Xhonsen Meti” ka marrë pjesë me pothuajse 90% në importin e MV nga Mbretëria e Bashkuar dhe me mbi 15% në importin e përgjithshëm të Republikës të Maqedonisë së Veriut në vitin 2018. Për shkak të vendosjes organizative të kompanive të huaja nga Mbretëria e Bashkuar të cilat importojnë lëndë të para nga vendi domicil, kurse produktet e gatshme i eksportojnë në Gjermani, të dhënat në anën e eksportit duhet të shqyrtohen nga aspekti i pasqyrës më të gjërë. Kontributi i firmave me prejardhje britanike është mjaftë i madh në eksportin e përgjithshëm të MV, edhe pse ajo nuk pasqyrohet mbi eksportin e drejtëpërdrejtë nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Mbretërinë e Bashkuar, por mund të shihet përmes eksportit në Gjermani.

Dhjetë produktet më të rëndësishme eksportuese nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Gjermani janë të lidhura me tre industri – automobilistike, prodhimtari të makinerive dhe aparateve dhe tekstile. Dy produktet kryesore eksportuese – katalizatorët me bazë nga metalet e çmuara dhe makineritë dhe



aparatet për pastrimin dhe filtrimin e gazrave janë drejtëpërdrejtë të lidhura me importin nga Mbretëria e Bashkuar. Eksporti i këtyre dy produkteve në Gjermani kryhet nga "Xhonsen Meti" respektivisht përmes tyre pasqyrohet raporti import nga Mbretëria e Bashkuar – prodhim në Republikën e Maqedonisë së Veriut – eksport në Gjermani. Edhe produktet tjera më të eksportuara në Gjermani janë kryesisht nga IHD në vend.

Kjo rrjedhë e tregtisë, me çrast importi i lëndëve të para është nga një vend (Mbretëria e Bashkuar), prodhimi i produkteve të gatshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kurse eksporti në shtetin tjetër (Gjermani), udhëzon në çështjen për nevojën e përdorimit të instrumentit të prejardhjes të mallrave. Kontrollimi nëse gjatë eksportit të produkteve më të rëndësishme në Gjermani, në mënyrë rrjedhëse përdoret instrumenti i prejardhjes të mallit që tregon se produktet e gatshme nga industria automobile kryesisht eksportohen nën numër të ri tarifor, dhe jo me zbatimin e rregullës të vlerës që është thelbësore gjatë kumulimit të prejardhjes. Kjo do të thotë se prejardhja e mallrave nuk do të jetë problem për tregtinë rrjedhëse britanike – maqedonase pas bregzit. Sidoqoftë, çështja prejardhjes të mallrave duhet të rregullohet në mënyrë sistemore ndërmjet dy palëve që të sigurohen kushtet më të favorshme për tregti.

Vendosja rrjedhëse e rrjedhave tregtare maqedonase – britanike tregon se kjo tregti është jashtëzakonisht e rëndësishme për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Rrjedhimisht, është me rëndësi të rregullohen marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar që të parandalohet çfarëdo dëmtimi i marrëdhënieve tregtare. Nëse deri në daljen faktike të Mbretërisë të Bashkuar nga tregu i përbashkët i Bashkimit Europian nuk ka një marrëveshje tregtare bilaterale të shkruar apo menjëherë të zbatueshme ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar, kjo do të rezultojë në zbatimin e rregullave të Organizatës botërore të tregtisë, që është një situatë më pak e favorshme në lidhje me rregullat ekzistuese preferenciale. Siç është përmendur, MPBT është tashmë e harmonizuar dhe objekt i nënshkrimit të ardhshëm, ashtuqë pritet që të mos ketë ndërprerje në tregtinë preferenciale.

Çështja e vetme e cila me shumë gjasa do të duhet të rishikohet sërish është Protokollu IV, i cili i referohet prejardhjes të mallrave. Në këtë kontekst, me rëndësi është harmonizimi i MPBT me ndryshimet në tekstin e Konventës PEM të cilat një kohë më të gjatë janë lëndë e negociatave. PEM konventa është thelbësore për Republikën e Maqedonisë së Veriut në kontekst të prejardhjes të mallrave, si dhe përkufizimit të statusit të Mbretërisë të Bashkuar në lidhje me këtë Konventë. Kumulimi i prejardhjes në rrjedhat ekzistuese tregtare ndërmjet Mbretërisë të Bashkuar – Republikës të Maqedonisë së Veriut – Gjermanisë rrallëherë përdoret si instrument për produktet më të rëndësishme eksportuese, megjithatë kjo çështje duhet të zgjidhet në mënyrë më të favorshme, me qëllim të sigurimit të platformës më të gjërë për shpërndarjen e tregtisë. Hyrja në kompaninë "Xhonsen Meti" në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka treguar se një kompani mund të ketë ndikim të fuqishëm mbi shkëmbimin tregtar të një vendi dhe të tërheq ndryshimin e shpejtë të strukturës të shkëmbimit tregtar, për arsye se në interes të Republikës të Maqedonisë së Veriut është rregullimi i të gjithë çështjeve tregtare në marrëveshjet preferenciale në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të saktë.



E përmbledhur, pikat më të rëndësishme nga platforma pas bregzit për bashkëpunimin tregtar ndërmjet Republikës të Maqedonisë dhe Mbretërisë të Bashkuar janë këto:

1) Me MPBT vendoset zona e tregtisë së lirë ndërmjet dy palëve (Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Mbretëria e Bashkuar). Kjo është në frymën e përparimit të arritur me MSA dhe ndërtimin e marrëveshjeve të mëtutjeshme përmec avancimit të bashkëpunimit tregtar.

2) MPBT parashikon që të mos ketë periudhë të mosrregullimit të marrëdhënieve tregtare ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme sepse në të kundërtën do të vlejnin dispozitat e Organizatës botërore të tregtisë të cilat janë më pak të favorshme se sa dispozitat e dakorduara dhe zbatuara përmes MSA.

3) MPBT do të sigurojë respektimin e zgjidhjes ndërmjet BE dhe Mbretërisë të Bashkuar, duke patur parasysh MSA. Në këtë kontekst, kryesor është zbatimi i MPBT pas përfundimit të periudhës tranzitore për zgjidhjen e çështjeve tregtare që rrjedhin nga Bregziti. Kjo periudhë është përcaktuar në mënyrë vijuese deri në 31 dhjetor të vitit 2020, me mundësi për vazhdim prej 12 apo 24 muajsh.

4) Rregullimi i një pjesë të tregtisë përmes kuotave, në bazë të zgjidhjes të zbatuar në MSA është përkatës për produktet e zgjedhura. Kuotat e prezantuara nga ana e Mbretërisë të Bashkuar janë të favorshme sepse japin hapësirë për intensifikim të rëndësishëm të tregtisë ndërmjet dy palëve, që duhet të nxitet me masa përkatëse tregtare.

5) Produktet janë përfshirë me Protokollin I (tekstil dhe veshje) dhe Protokollin II (produkte të çelikut) është rregulluar që të jenë lëndë e tregtisë të lirë me MPBT, duke ndjekur arritjet nga MSA. Produktet e tekstit dhe veshjet janë produkte tradicionale me të cilat tregtojnë dy palët dhe duhet të kërkohen mënyra për ngritjen e mëtutjeshme të eksportit në këtë sektor të tregut britanik, pa kufizime tregtare.

6) Protokollin IV, i cili i referohet prejardhjes të mallrave dhe metodave të bashkëpunimit administrativ përfshin përkufizimin e rregullave dhe qasjes territoriale në lidhje me prejardhjen e mallrave me atë që Zvicra, Lihtenshtajni, Islanda, Norvegjia (vendet EFTA), Turqia dhe Bashkimi Europian janë përfshirë në kumulimin e prejardhjes edhe në Mbretërinë e Bashkuar edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Shtrirja e propozuar territoriale dhe rregullat e kumulimit të prejardhjes të mallrave në MPBT mund të vlerësohen si pozitive në kontekst të mbajtjes të kushteve ekzistuese të tregtisë. Sidoqoftë, duhet të kihet parasysh se çdo ndryshim në Konventën PEM, që është thelbësor për Republikën e Maqedonisë së Veriut në lidhje me marrëveshjet tregtare me BE, do të duhet të reflektohet edhe në ndryshimin e MPBT.

Në bazë të analizës, vlerësimi është se zgjidhjet në MPBT janë ndërtuar në bazë të përfitimeve nga MSA, që paraqet një pikë të mirë të fillimit për përparimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve tregtare. Nuk ka zgjidhje për vendosjen e mekanizmave të reja mbrojtëse që udhëzon në atë se intensifikimi i tregtisë inkurajohet që të nxitet përmes ndërtimit të mundësive dhe konkurrencës, dhe jo përmes mbrotjes. MPBT është një platformë bashkëkohore për bashkëpunimin tregtar ndërmjet Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë të Bashkuar që duhet të promovohet përmes politikës përkatëse tregtare dhe që të orientohet komunitetit afarist që ta përdor më shumë.



MATERIALET E KONSULTUARA DHE BURIMET INFORMACIONIT

Dokumentet

1. Partnership, Trade and Cooperation Agreement between the Republic of North Macedonia and the United Kingdom (in the signing stage)
2. Regional Convention on pan-Euro-Mediterranean preferential rules of origin
https://ec.europa.eu/taxation_customs/business/calculation-customs-duties/rules-origin/general-aspects-preferential-origin/arrangements-list/paneuromediterranean-cumulation-pem-convention_en
3. Political Declaration setting out the framework for the Future Relationship between the European Union and the United Kingdom, October 2019
4. Stabilisation and Association Agreement between the Republic of Macedonia and the European Communities and their Member States (Official Gazette of the Republic of Macedonia 28/2001)

Mediat informative

1. BBC EU-UK Post Brexit trade talks
<https://www.bbc.com/news/topics/c4vm89lx8e8t/eu-uk-post-brexit-trade-talks>
2. Bloomberg/ Brexit
<https://www.bloomberg.com/brexit>
3. Financial Times/ Brexit
<https://www.ft.com/brexit>



Ueb faqet e institucioneve zyrtare

1. Qeveria e Mbretërisë të Bashkuar - Bregzit
<https://www.gov.uk/brexit>
2. Bashkimi Europian
<https://ec.europa.eu>
3. Bashkimi Europian – negociatat me Mbretërinë e Bashkuar
https://ec.europa.eu/info/european-union-and-united-kingdom-forging-new-partnership/future-partnership/negotiation-rounds-future-partnership-between-european-union-and-united-kingdom_en
4. Ministria për punë të jashtme e Republikës të Maqedonisë së Veriut
<https://www.mfa.gov.mk>
5. Sekretariati për çështje europiane i Republikës të Maqedonisë së Veriut
<https://www.sep.gov.mk>
6. Kuvendi i Republikës të Maqedonisë – dokumentet e RM/EU
<https://www.sobranie.mk/documents-rm-eu.nspx>
7. Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar - Bregzit
<https://www.parliament.uk/business/publications/research/eu-referendum/legislation/>
8. Administrata doganore e Republikës të Maqedonisë së Veriut
<https://www.customs.gov.mk>

Bazat statistikore

1. Enti shtetëror për statistika i Republikës të Maqedonisë së Veriut – baza e të dhënave MAKSTAT
<http://makstat.stat.gov.mk>
2. Qendra ndërkombëtare tregtare – baza e të dhënave INTRACEN
<http://trademap.org>
3. Banka popullore e Republikës të Maqedonisë së Veriut – statistikat IHD
<http://nbstat.nbzm.mk/pxweb/mk/Eksterni%20statistiki/>